

Raiffeisen Bank Shqipëri

Raport Vjetor 2017

Përmbajtje

Mesazh nga Kryetari i Këshillit Drejtues	6
Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm	7
Misioni	8
Perspektivat dhe Planet për vitin 2018	9
Raporti i Bordit Drejtues	12
Zhvillimet ekonomike	12
Rezultatet Financiare	13
Raporti i Segmenteve	20
Segmenti Korporatë	20
Segmenti i Bizneseve të Vogla (SE)	21
Divizioni i Produkteve Korporatë dhe SE	21
Retail Banking	24
Zhvillimi i Segmenteve	24
Divizioni i Produkteve	25
Divizioni i Biznesit me Karta dhe Bankingut Elektronik	26
Kanalet e Shpërndarjes	28
Thesari dhe bankingu i Investimeve	30
Të ardhurat fikse	30
Tregu i parasë	30
Këmbimi valutor	31
Shitjet e thesarit	31
Përgjegjësia Sociale	34
Burimet Njerëzore dhe Trajnimet	35
Raporti i Auditorit të Pavarur	41
Raiffeisen Leasing	114
Rreth Raiffeisen Invest Sh.a	118
Një vështrim mbi Raiffeisen Bank International	122
Rrjeti i Raiffeisen Bank Sh.a	123
Adresa dhe Kontakte	124



Egon Lerchster
Anëtar Bordi për
TI & Operacionet

Christian Canacaris
Drejtor i Përgjithshëm

Elona Mullahi (Koçi)
Anëtare Bordi për Korporatat & SE

Alexander Zsolnai
Zëvendës Drejtor
i Bordit Drejtues

John McNaughton
Anëtar Bordi për Biznesin Retail



BORDI DREJTUES

i Raiffeisen Bank Sh.a



Raporti i Bordit Mbikqyrës

Zonja dhe Zotërinj,

Gjatë vitit financiar 2017 përgjithësisht mbizotëroi një prirje makroekonomike pozitive dhe një mjedis ekonomik i favorshëm. Kjo gjë kontribuoi në përmirësimin e madh vit pas viti të fitimit të konsoliduar të RBI, i cili krahasuar me vitin e kaluar u rrit më shumë se dyfish. Rezultati pozitiv erdhi më së shumti si pasojë e kostove me risk të ulët. Së bashku me shitjen e suksesshme të kredive të këqija, ndikim pati edhe një rënie e ndjeshme e provigjoneve neto të humbjeve të pakthyeshme. Rezultatet e arritura nga RBI në 2017 konfirmojnë gjithashtu se vendimet strategjike të ndërmarra gjatë viteve të kaluara kanë luajtur një rol kyç që grupi ynë të dalë me sukses nga një periudhë sfiduese transformimi me më shumë forcë. Kjo tregohet edhe nga një forcim i qendrueshëm i kapitalit bazë, pozicion i balancuar risku dhe një rënie e ndjeshme e raportit të NPL – nga 8,7 përqind (në 2016) në 5,7 përqind. Ky përmirësim në cilësinë e aseteve vjen si pasojë e rënies së ndjeshme të kredive të këqija gjatë viteve të fundit.

Shkrirja e Raiffeisen Zentralbank Österreich AG me RBI AG u bë efektive menjëherë sapo u regjistrua në regjistrin tregtar në 18 Mars 2017. Pas shkrirjes RBI do të vazhdojë me strategjinë e saj si grup bankar udhëheqës në EQL dhe Austri, me objektivin kryesor të krijimit të vlerave afatgjata.

Në vitet në vazhdim është planifikuar rritje e përzgjedhur në tregje specifike të cilat tregojnë qendrueshmëri dhe perspektivë të mirë ekonomike. Manaxhimi efektiv i riskut dhe kapitalit si dhe ulja e mëtejshme e kredive të këqija do të mbeten shumë të rëndësishme në të ardhmen. Në 2018 do të rritet fokusi mbi sfidat në formën e kërkesave të vazhdueshme rregullatore, riskut politik, zhvillimi i dixhitalizimit dhe ndryshime lidhur me mjedisin konkurrues.

Për sa i përket Raiffeisen Bank Sh.a, do të doja të theksoja se pas një viti të vështirë si 2016, viti 2017 ishte një vit i sukseshëm për bankën. Gjithashtu do të doja të përmendja se banka regjistroi një nga fitimet më të larta në historinë e saj. Në vazhdim të këtij rezultati, Raiffeisen Bank Sh.a prezantoi platformën dixhitale më inovative në tregun bankar në vend, me numrin më të lartë të përdoruseve në më pak se një vit nga prezantimi i saj në treg.

Do të doja të përfitoja nga kjo mundësi për të falenderuar të gjithë punonjësit e Raiffeisen Bank sh.a në Shqipëri për punën e tyre dhe përpjekjet e vazhdueshme në 2017, dhe gjithashtu i kërkoj atyre të kenë të njëjtin përkushtim ndaj sfidave në të ardhmen.

Në emër të Bordit Mbikqyrës,



Peter Lennkh,
Drejtues i Bordit Mbikqyrës



Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm

Viti 2017 ishte një vit shumë pozitiv për Raiffeisen Bank në Shqipëri, me rezultate shumë të mira në të gjithë treguesit e performancës. Në veçanti, kredia retail u rrit në rreth € 250 milionë, duke përfunduar në këtë mënyrë praninë tonë në tregun e kredisë retail, dhe duke zënë tashmë 18.6 përqind të këtij tregu.

Një nga arritjet tona më të rëndësishme në vitin 2017 ishte prezantimi i platformës dixhitale "Raiffeisen ON". Kjo platformë e cila është projektuar për klientët individë dhe bizneset ofron shërbime bankare të shpejta dhe të sigurta nëpërmjet teknologjisë së saj të përparuar. Duke qenë platforma më inovative bankare në treg, Raiffeisen ON regjistroi rreth 40,000 përdorues aktivë individë dhe biznese deri në fund të vitit 2017, që nga prezantimi i saj në mars 2017.

Gjithashtu, ne jemi të kënaqur që i shërbejmë më shumë se 800,000 klientëve në mbarë vendin, duke ju ofruar atyre një gamë të gjerë të produkteve të kursimit, kredisë dhe pagesës. Raiffeisen Bank në Shqipëri vazhdon të ketë mbulimin me rrjetin më të madh të degëve dhe ATM-ve në vend.

Gjatë vitit 2017, vendi pati një rritje pozitive të PBB-së me 3.84 përqind, e cila u reflektua në asetet e përgjithshme bankare, që u rritën me 2.7 përqind nga viti në vit. Raiffeisen Bank është numri dy në treg për nga asetet dhe depozitat, të cilat përfaqësojnë respektivisht 17.1 dhe 17.8 përqind të tregut.

Ne përgjatë gjithë vitit vazhduam të fokusohemi në përmirësimin dhe zgjerimin e gamës së shërbimeve dhe produkteve që u ofrojmë klientëve tanë. Infrastruktura jonë është e modernizuar me degë të standardeve të larta, ku klientëve u shërben stafi ynë i trajnuar, sepse qëllimi ynë është që gjithmonë të ofrojmë shërbime të shkëlqyera për klientët tanë.

Për më tepër, Raiffeisen Leasing vazhdon të jetë zgjedhja e preferuar si për bizneset ashtu edhe për individët, të cilët kërkojnë financim në makineri, pajisje, mjete transporti dhe makina. Raiffeisen Leasing është kompania lider në tregun e leasingut, duke zotëruar më shumë se 40 përqind të tij.

Raiffeisen INVEST Sh.a vazhdon të jetë kompania lider në menaxhimin e asetëve në tregun financiar shqiptar me fokus të qartë në kujdesin ndaj investitorëve dhe zbatimin e praktikave më të mira të menaxhimit të asetëve. Raiffeisen INVEST promovon fondet për masën e gjerë të investitorëve dhe është e orientuar drejt rritjes së qëndrueshme dhe zhvillimit të tregut të fondeve të investimeve dhe të fondeve të pensioneve private.

Ne shpresojmë që 2018 të ketë të njëjtin ecuri si në vitin 2017. Me angazhimin e punonjësve tanë të mirë trajnuar, ne do të vazhdojmë të ofrojmë një shërbim të shkëlqyer për klientët tanë individë, korporata dhe SE, në mënyrë që Raiffeisen Bank Sh.a. të jetë zgjedhja e parë në sektorin bankar vendas.

Përveç kësaj, transformimi ynë dixhital do të vazhdojë me më shumë produkte dhe shërbime online, duke e bërë shërbimin bankar më të përshtatshëm dhe modelin tonë të biznesit me kosto më të efektshme.

Së fundi, në emër të bordit drejtues, do të doja të falenderoja sinqerisht të gjithë punonjësit tanë, klientët dhe partnerët e biznesit për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre gjatë vitit 2017 dhe unë besoj që viti 2018 do të jetë një tjetër vit i suksesshëm.



Christian Canacaris
Drejtor i Përgjithshëm
Kryetar i Bordit Drejtues



Misioni

|| *Ne rrisim standardet bankare dhe bëjmë ndryshimin në jetën e konsumatorit duke ofruar produkte konkurruese dhe shërbime me cilësinë më të mirë.*

Ne kërkojmë marrëdhënie afatgjata me klientët.

Si anëtarë të Raiffeisen Bank International, ne bashkëpunojmë ngushtë me RBI-në dhe me anëtarët e tjerë të grupit.

Ne arrijmë një kthim mbi kapitalin të qendrueshëm dhe mbi mesataren.

Ne i japim mundësi punonjësve tanë të jenë sipërmarrës, të tregojnë iniciativë dhe nxisim zhvillimin e tyre. **||**

Perspektivat dhe Planet për vitin 2018

Raiffeisen Bank planifikon të vazhdojë zhvillimin e saj dhe kontributin e mëtejshëm në ekonominë e vendit. Ne do të vazhdojmë të përqendrohemi tek të gjithë segmentet tona: Individë, Mikro, SE dhe Korporatë duke vazhduar investimet në produkte, shërbime, në teknologji dhe gjithashtu duke ofruar standardin më të lartë të shërbimit ndaj klientëve.

Në kuadër të transformimit të vazhdueshëm dixhital, ne do të vazhdojmë të jemi banka më e avancuar në vend, duke investuar në platformën dixhitale për të sjellë funksionalitete të reja në mënyrë që t'i ofrojmë klientëve tanë zhvillimet më të fundit për ta bërë eksperiencën e tyre bankare sa më të lehtë.

Në vitin 2017, Raiffeisen Bank vazhdoi të ishte zgjedhja e parë bankare për më shumë se 800,000 klientë në të gjithë vendin. Cilësia e shërbimit ndaj klientit në të gjitha segmentet do vazhdojë të jetë prioritet. Segmenti i Klientëve Individë do të vazhdojë të fokusohet në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve më të mira në treg si kreditë konsumatore, platforma dixhitale, etj.

Gjithashtu do të vazhdojmë ti shërbejmë klientëve tanë korporatë dhe SE, duke u fokusuar në projektet e suksesshme dhe do të vazhdojmë të ofrojmë një gamë të gjerë shërbimesh bankare si për biznesin dhe për punonjësit e tyre. Shërbimi i platformës dixhitale do të jetë një prioritet edhe për këto segmente.

Ecëm përgjatë këtij viti falë punonjësve më të mirë në tregun bankar në Shqipëri. Ne punuam dhe fituam ndaj sfidave si një skuadër. Për këtë arsye dëshirojmë të falenderojmë të gjithë punonjësit për përpjekjet dhe punën e tyre. Ne do të mbajmë këtë pozicion dhe do të përballojmë sfidat e reja edhe për vitin 2018.

Së fundmi, do të dëshironim të falenderonim sinqerisht të gjithë klientët dhe partnerët e biznesit për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre gjatë vitit 2017. Ne mbetemi të përkushtuar për të përmbushur kërkesat tuaja bankare, duke ju ofruar një shërbim me cilësi të lartë në çdo pikë kontakti që mund të keni me ne. Ne do të bëjmë më të mirën për të qenë gjithmonë zgjedhja juaj e parë si partner bankar.

Bordi Drejtues
Raiffeisen Bank Sh.a



Christian Canacarisi
Drejtor i Përgjithshëm



Alexander Zsolnai
Zëvendës Drejtor i
Bordit Drejtues



John McNaughton
Anëtar Bordi për
Biznesin Retail



Elona Mullahi (Koçi)
Anëtare Bordi për
Korporatat & SE



Egon Lerchster
Anëtar Bordi për TI &
Operacionet

Evolucion





Raporti i Bordit Drejtues

Zhvillimet Ekonomike

Ekonomia u përshpejtua në vitin 2017 duke u rritur me 3.9 përqind mesatarisht në tre tremujorët e parë krahasuar me rritjen prej 3.4 përqind që shënoi në 2016-tën. Forcimi i ritmit të rritjes ekonomike në 2017-ën u mbështet kryesisht nga zgjerimi i konsumit dhe investimeve, si dhe nga rritja e eksporteve shqiptare, e në veçanti të eksportit të shërbimeve të turizmit. Të gjithë sektorët ekonomikë industria, shërbimet, ndërtimi dhe bujqësia kanë kontribuar pozitivisht në zgjerimin e prodhimit përgjatë 2017-tës. Ekonomia pritet të ruajë të njëjtat nivele të mira rritjeje prej 3.8 përqind - 4.0 përqind në 2018-ën mbështetur nga kërkesa e brendshme e inkurajuar nga kushtet e mira të financimit, niveli i rritur i besimit dhe nga avancimi i reformave strukturore. Rimëkëmbja ekonomike e pritur e partnerëve kryesorë tregtarë në rajon do të ndikojë pozitivisht ekonominë vendase.

Inflacioni në 2017 rezultoi në rritje në nivelin 2.0 përqind mesatarisht krahasuar me 1.3 përqind që ishte në 2016, por përsëri mbeti larg objektivit të 3.0 përqind të Bankës së Shqipërisë. Kontributin kryesor e dhanë çmimet e ushqimeve, ndërsa inflacioni bazë dhe inflacioni i importuar mbeten në nivele të ulta. Politika monetare vazhdoi të ishte stimuluese në 2017-tën me një normë bazë në nivelin më të ulët historik të 1.25 përqind të vendosur që prej Majit 2016. Në 2018-ën pritet një inflacion mesatar prej 2.4 përqind dhe një kthim në objektiv brenda gjysmës së parë të vitit 2019, e si rrjedhim dhe politika monetare nuk pritet të uli intensitetin e stimulit monetar të paktën deri në fund të 2018-ës.


Zhvillimet në tregun e punës kanë shfaqur shenja përmirësimi përgjatë 2017-tës. Shkalla e papunësisë në fund të vitit 2017 rezultoi 13.4 përqind në rënie nga niveli 14.2 përqind në fund të vitit 2016. Punësimi në tremujorin e fundit të 2017 u rrit me 4.3 përqind në terma vjetorë dhe sektorët që prodhuan më tepër punësim ishin shërbimet dhe industria ndërsa bujqësia shënoi rënie.

Konsolidimi fiskal vazhdoi edhe në 2017-ën, ku deficieti buxhetor rezultoi në nivelin e 231.2 milion Euro, ose 2.0 përqind e PBB-së, brenda objektivit të vendosur të buxhetit. Të ardhurat buxhetore u rritën me 5.7 përqind nga viti në vit, por gjithsesi mbetën 2.8 përqind poshtë planit. Edhe shpenzimet buxhetore rezultuan të rritura në krahasim me vitin e kaluar prej 6.4 përqind, megjithatë nën buxhet për shkak të shkurtimeve në shpenzimet korente dhe kapitale. Tendenca e raportit të borxhit publik mbi PBB-në vazhdoi të jetë rënëse edhe në 2017-tën. Në fund të vitit 2017, borxhi publik mbi PBB-në rezultoi 69.9 përqind nga 72.4 përqind në 2016-tën. Politika konsoliduese fiskale pritet të vazhdojë në 2018-tën dhe raporti i borxhit publik të ulët më tej.

Pozicioni i jashtëm i vendit u përmirësua në nëntëmuorin e parë të 2017-tës, pasi deficieti i llogarisë rrjedhëse rezultoi në nivelin e 520 milion Euro, duke u ngushtuar me 18 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Eksportet e të mirave dhe shërbimeve u rritën me 23.3 përqind nga viti në vit në periudhën Janar-Shtator 2017 pasi eksportet e shërbimeve u rritën me 24.8 përqind, kryesisht për shkak të performancës së mirë të turizmit, por edhe sepse eksportet e të mirave u rritën në mënyrë të konsiderueshme me 18.1 përqind në këtë periudhë. Në fund të Shtator 2017, investimet e huaja direkte arritën 724.6 milion Euro me rritje vjetore prej 6.6 përqind, duke financuar kështu deficitin e llogarisë rrjedhëse. Remitancat arritën 463.5 milion Euro deri në Shtator 2017, me një rritje prej 3.2 përqind në krahasim me një vit më parë.

Aktiviteti i përgjithshëm i sektorit bankar u zgjerua lehtësisht në 2017 me një rritje vjetore të aktiveve prej 2.7 përqind (6.8 përqind në 2016). Kredithënia mbeti pothuajse në të njëjtin nivel si vitin e kaluar duke u rritur vetëm me 0.1 përqind në 2017-tën. Volumi i ri në 2017 erdhi prej dhënies së kredive në monedhën vendase, duke reflektuar dhe transmetimin e politikës stimuluese. Duke parë drejt 2018-tës, perspektiva e kredithënies është pozitive duke reflektuar rritjen e pritshme ekonomike në nivelin 3.8-4.0 përqind si dhe nivelet e përmirësuar të kredive të këqija. Në fund të 2017-tës, niveli i kredive të këqija ra në 13.2 përqind të totalit të kredive nga 18.3 përqind në 2016-tën. Implementimi i masave të marra për uljen e kredive me probleme të këqija përgjatë 2017, vazhdimi i procesit të pastrimit të bilanceve të bankave nga kreditë e humbura dhe përmirësimet në procesin e ristrukturimit ndikuan pozitivisht në uljen e nivelit të kredive të këqija. Sistemi bankar shënoi performancë të mirë financiare në 2017-tën, duke kapur nivelin rekord të fitimit neto prej 166 milion Euro. Sistemi bankar mbeti likuid dhe i mirëkapitalizuar në 2017-tën, me raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 16.6 përqind krahasuar me minimumin e kërkuar prej 12.0 përqind.


Rritja e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (%nga viti në vit)



Rezultatet Financiare


Totali i aktiveve në fund të vitit 2017 ishte 250,455 milion Lekë (2016: 270,537 milion Lekë). Në 2017 portofoli i kredisë, përfaqësonte 36 përqind (2016: 33 përqind) të totalit të aktiveve të bankës. Investimet në letra me vlerë përfaqësojnë rreth 33 përqind të totalit të aktiveve në 2017 (2016: 35 përqind).

Struktura e Bilancit - Aktivi (në '000 LEK)




Totali i huave dhe paradhënieve për klientët në fund të vitit 2017 ishte 103,048 milion Lekë (2016: 110,383 milion Lekë) duke përfaqësuar kështu një rënie prej 7 përqind të portofolit të kredisë gjatë këtij viti. Sektori i Korporatave përfaqëson 57 përqind të totalit të portofolit të kredisë dhe zuri vendin kryesor në këtë portofol me një tepricë kredie prej 58,763 milion Lekë (2016: 67,450 milion Lekë). Segmentet e Ndërmarrjeve të Mesme shënuan një rënie në portofolin e kredisë përkatësisht 6 përqind. U shënuan një rënie në portofolin e kredisë prej 35 përqind për segmentin e ndërmarrjeve të vogla me një tepricë prej 1,205 milion Lekë (2016: 1,859 milion Lekë).

Struktura e Hua dhe Paradhënie për klientët
(në '000 LEK)



Në 2017 portofoli i kredisë përbëhet kryesisht nga një kombinim i paradhënies bankare prej 45 përqind (2016: 44 përqind), i kredisë afatmesme prej 17 përqind (2016: 19 përqind) dhe i kredisë afatgjatë që përfaqëson 19 përqind të totalit të portofolit të Bankës për 2017 (2016: 18 përqind).


Kredi gjatë vitit 2017
(në '000 LEK)



Totali i detyrimeve në fund të vitit 2017 ishte 220,121 milion Lekë (2016: 244,939 milion Lekë). Në 2017, pjesën më të madhe të detyrimeve e zënë depozitat e klientëve, të cilat përbëjnë rreth 93 përqind (2016: 94 përqind) të totalit të detyrimeve.

Struktura e Bilancit - Pasiv


(në '000 LEK)



Ashtu si në 2016, profili i depozitave të klientëve në 2017 tregon një tendencë të depozituesve për t'u larguar nga depozitat me afat të shkurtër maturimi. Me qëllim përfitimin nga interesat më të larta, klientët po investojnë kursimet e tyre në depozita me afat më të gjatë maturimi. Totali i depozitave të klientëve në fund të vitit 2017 është 64,537 milion Lekë (2016: 77,730 milion Lekë).

Struktura e Depozitave


(në '000 LEK)



2017 shënoi një rritje prej 213 përqind të fitimit pas taksës në krahasim me 2016 në 4,735 milion Lekë (2016: -4,204 milion Lekë) duke ndryshuar raportin e kthimit mbi kapitalin nga 0 përqind në 2016 në 17.71 përqind në 2017. Nuk kishte dividend të deklaruar dhe të paguar në 2017 (2016: 281 milion Lekë).

Struktura e Kapitalit Aksioner


(në '000 LEK)



E ardhura neto nga interesat u pakësua me 7 përqind ose nga 7,686 milion Lekë në 2016, në 7,141 milion Lekë në 2017. Rënia e të ardhurës nga interesat bashkë me rënieën e totalit të aktiveve të bankës prej 7.4 përqind, nuk ndikoi në marzhin e interesit (llogaritur si raport i të ardhurës nga interesat mbi mesataren vjetore të totalit të aktiveve) që është 2.74 përqind në 2017 dhe 2016.

Të ardhura neto

(në '000 LEK)




Shpenzimet administrative në total gjatë 2017 arritën në 2,357 milion Lekë (2016: 2,725 milion Lekë). Efiçenca operuese e Bankës – raporti kosto/të ardhura ndryshoi nga 60.45 përqind në 58.65 përqind.

Shpenzimet për stafin u ulën me 8.41 përqind ose 2,355 milion Lekë në 2017 krahasuar me 2,571 milion Lekë në 2016.


Shpenzime operative 2017

(në '000 LEK)



Fitimi & ROE

(në '000,000 ALL)







Progres

Raporti i Segmenteve

Segmenti Korporatë

Ashtu si vitin e kaluar, edhe këtë vit, fokusi i segmentit të korporatës ishte ofrimi i shërbimit sa më të mirë ndaj klientëve ekzistues. Gama e gjerë e produkteve, shërbimet e personalizuara që u ofrohen klientëve ekzistues dhe klientëve të rinj, kanë shënuar vit pas viti rritjen e biznesit dhe konsolidimin e marrëdhënieve me klientët e segmentit. Kreditimi në industrinë e synuara dhe strategjike që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit ka qenë një nga prioritetet e segmentit të korporatave.

Cilësia e portfolit ka vazhduar të jetë një nga objektivat kryesore në segmentin e korporatave përmes analizës së kujdesshme për zbutjen e rrezikut të ndërmarrë. Fokusi kryesor i segmentit të korporatës gjatë vitit të kaluar ishte optimizimi i përfitueshmërisë përmes diversifikimit dhe rritjes së produkteve të shfrytëzuara nga konsumatorët.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit dhe përmirësimit të mjeteve të brendshme për të lehtësuar dhe përmirësuar procesin e shitjeve, duke sjellë një rritje të përgjithshme të efikasitetit dhe produktivitetit.

Pas përvojës pozitive të viteve të mëparshme, madje edhe gjatë vitit 2017, fokusi i veçantë i është kushtuar produkteve të specializuara të financimit, si produktet e Financës Tregtare. Ne kemi vazhduar të ruajmë pjesën tonë të tregut në produktet e Financës Tregtare gjatë 2017, duke e arritur këtë përmes një ekipi të përkushtuar që i mbështet klientët tanë strukturimin e nevojave të tyre për produkte të tilla në mënyrë që të zbusin rrezikun e tyre në tregtinë ndërkombëtare. Produktet e Financës Tregtare regjistrojnë një kontribut të vazhdueshëm në rritje në të ardhurat bruto. Deri në fund të vitit 2017 kontributi i këtyre produkteve është rritur me 8 përqind në vit.

Gjatë muajit mars 2017, Raiffeisen Bank hodhi në treg produktin më inovativ, interaktiv dhe më të sigurt në Shqipëri për klientët e biznesit. Raiffeisen ON është një produkt bankar i thjeshtë, efektiv dhe i sigurt për klientët e biznesit, i cili konsideron nevojën e përdoruesit për të komunikuar me bankën përmes të gjitha kanaleve në dispozicion, si shërbimet bankare web dhe mobile.

Teknologjia e nivelit të lartë dhe përkushtimi i plotë i manaxherëve tanë të produkteve dhe specialistëve të marrëdhënies me klientët, bënë të mundur një migrim të lehtë nga platforma e mëparshme në atë të re në kohën më të shkurtër të mundshme, ndërsa shfrytëzimi i platformës dixhitale arriti nivele shumë të kënaqshme me një rritje prej 65 përqind në vit.

Në fund të vitit 2017, rezultati për segmentin e korporatave regjistroi një vlerë rekord prej 17 milionë euro fitim neto. Ky rezultat pasqyron një menaxhim të kujdesshëm të të gjitha nismave të lartpërmendura dhe gjithashtu objektivin tonë për të qenë një bankë lider në fuqjen e zgjidhjeve të reja dhe inovative në treg dhe vazhdimisht përmirësimin e shërbimit për klientët tanë.

Divizioni i Korporatave shërben për kategoritë e mëposhtme të konsumatorëve:

- Korporatat Vendase
- Korporatat Ndërkombëtare
- Institucionet Publike dhe Njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe Vendore dhe Organizatat Joqeveritare

Raiffeisen Bank, si partneri kryesor financiar i qeverisë shqiptare, mban një rol të rëndësishëm në mbështetjen e projekteve publike përmes strategjive specifike, zgjidhjeve të përkushtuara për produktet dhe shërbimet bankare si dhe sistemet e komunikimit. Ky bashkëpunim i ngushtë ka çuar në një përmirësim gjithnjë e më të madh, më transparent dhe efikas të fondeve publike, vit pas viti. Aktualisht, Raiffeisen Bank proceson listat e pagave për shumicën e punonjësve të sektorit publik dhe manaxhon gati një të tretën e shpenzimeve publike.

Biznesi i vogël (SE)

Biznesi i vogël (SE), përfaqëson një potencial strategjik për Raiffeisen Bank dhe synimi ynë është të mbështesim rritjen e këtyre bizneseve nëpërmjet një përfaqëse bazuar në disa specifika si madhësia, profili, llojet e transaksioneve dhe kërkesave të tyre të financimit.

Portofoli i kreditë për segmentin SE ruajti një rritje të qëndrueshme edhe gjatë vitit 2017 me një volum kreditësh të reja të disbursuara në shumën 28 milionë Euro ose 22 përqind më shumë krahasuar me një vit më parë.

Në maj 2017, Raiffeisen Bank në bashkëpunim me Fondin European të Investimeve (EIF) implementoi iniciativën që i lejon klientët SE të përfitojnë zgjidhje financimi me kërkesa të thjeshtuara për sa i përket kolateralit dhe një normë interesi të përballueshme nga ata. Kjo skemë garancie pati një ndikim shumë të madh në rritjen e portofolit të kredive si dhe në lehtësimin e procedurave të financimit për shumë klientë SE të shpërndarë në të gjithë territorin Shqiptar.

Rritja e aseteve dhe numrit të klientëve ka qenë vetëm njëri nga dimensionet tona të marrëdhënieve me klientët. Një fokus shumë i rëndësishëm i është dhënë dhe investimit në teknologji. Kështu, në mars 2017 është hedhur në treg platforma dixhitale Raiffeisen ON dhe rezultatet ishin përtej pritshmërive. Në dhjetor 2017 rreth 54 përqind e totalit të volumit të pagesave të bëra nga të gjithë klientët SE u kanalizuan në platformë, krahasuar me 28 përqind një vit më parë. Ky është një rezultat i shkëlqyer për segmentin SE, jo vetëm sepse ul kostot e transaksioneve, por edhe sepse rriti kënaqësinë e klientëve.

Produktet e strukturuar vazhdojnë të mbeten një fokus kryesor për ne. Edhe për vitin 2017 ne vazhdojmë të tejkalojmë buxhetin për Produktet e Financave Tregtare, numrit total të pagesave dhe fitimit përkatës të gjeneruar nga këto produkte. Përkushtimi ynë për të rritur gjithmonë cilësinë e shërbimit dhe produkteve tona, vazhdon të mbetet avantazhi ynë konkurrues. Në këtë drejtim gjatë vitit 2017 kemi ndërmarrë disa iniciativa, një pjesë e të cilave vazhdojnë edhe gjatë 2018, me qëllim lehtësimin e proceseve për produktet dhe shërbimet tona, dhe nga ana tjetër të jemi më pranë klientëve tanë me oferta të përshtatshme për kërkesat e tyre.

Lidhur me cilësinë e portofolit të kredive, fokusi i vazhdueshëm, kujdesi dhe puna e bërë për monitorimin e portofolit të kredive ka ndikuar në uljen e vazhdueshme të raportit të kredive të këqija. Ky raport u ul në nivelin 10 përqind në dhjetor 2017 krahasuar me 12.8 përqind në dhjetor 2016. Qëllimi ynë për të ardhmen është që të vazhdojmë të punojmë në të njëjtën mënyrë për të reduktuar më tej raportin e kredive të këqija.

Divizioni i Produkteve Korporatë dhe SE

Produktet e Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër

Njësia e Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër, përmes një stafi të specializuar, ofron shërbimin e këshillimit të klientëve të saj lidhur me përdorimin e duhur të transaksioneve të Financave Tregtare si Garancitë Bankare, Letër Kreditë dhe Dokumentat për Arkëtim, duke i ndihmuar klientët të reduktojnë riskun e marrëdhënieve tregtare me partnerët respektivë ndërkombëtarë dhe vendas. Raiffeisen Bank ka një numër të konsiderueshëm bankash korrespondente, të shpërndara në të gjithë botën, të cilët veprojnë si partnerë dhe ndihmojnë për arritjen e një performance të suksesshme në transaksionet e Financave Tregtare.

Raiffeisen Bank i mbështet klientët e saj në realizimin në kohë dhe me cilësi të transaksioneve të Letër Kreditë (Import dhe Eksport), Garancive Bankare (direkte dhe indirekte), Letër Kreditë Stand By dhe Dokumentet për Arkëtim (Import dhe Eksport). Banka ka ekspertizën e duhur teknike dhe luan një rol të rëndësishëm në edukimin e klientëve në lidhje me mënyrën dhe avantazhet e përdorimit të Produkteve të Financave Tregtare dhe ka vijuar të kontribuojë në ndërgjegjësimin dhe rritjen e shkallës së përdorimit të këtyre produkteve nga klientët e segmentit Korporatë dhe SE. Puna e Njësise së Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër në bashkëpunim me forcën shitëse ka kontribuar në mbajtjen e një niveli të lartë të volumeve të realizuara në këtë fushë edhe për vitin 2017.

Njësia e Produkteve të Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër mbështet gjithashtu klientët korporatë të bankës në njohjen dhe konsiderimin e produktit të Faktoringut si një mundësi alternative për financimin dhe menaxhimin më efektiv të nevojave të tyre për likuiditet.

Në fushën e Financave Tregtare, banka ka vijuar të ruaj avantazhin e saj konkurrues në treg, duke mbajtur një nivel të lartë specializimi, i cili përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes trajnimit të rregullt të specialistëve, mbështetjes së RBI-së në Vjenë, bashkëpunimit të vazhdueshëm me bankat e rrjetit si dhe duke shfrytëzuar strukturat e saj të balancuara dhe kanalet e gjëra të shpërndarjes

Njësia e Financimit të Projekteve dhe Investimeve Afatgjata

Njësia e financimit të projekteve është e angazhuar në vlerësimin e nevojave të financimit dhe në ofrimin e shërbimeve financiare për projekte industriale dhe pasuri të paluajtshme sikurse transaksione të strukturuar të financimeve afatgjata që lidhen me blerje asetesh apo shkrirje kompanish.

Ne jemi vazhdimisht të përqëndruar në rritjen e bashkëpunimit me klientët tanë të cilët gjejnë në Raiffeisen Bank një partner të denjë për të ofruar produkte dhe shërbime specifike duke respektuar praktikën më të mira të tregut. Eksperienca dhe aftësitë profesionale gjatë bashkëpunimeve tona rendisin Raiffeisen Bank si një partner të denjë të institucioneve ndërkombëtare financiare, duke i besuar një rol aktiv në financimet e strukturuar kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke pasur në fokusin tonë nevojat financiare të klientëve, njësia është e angazhuar të vlerësojë aspektin teknik, ligjor dhe strukturën financiare të çdo projekti, sikurse dhe të monitorojë performancën e tyre, prej fazës fillestare deri në përfundim të tij.

Të përkushtuar në përfundimin me sukses të çdo projekti dhe duke ofruar fleksibilitet në financim, në përputhje me dinamikën e tregut, cilësitë kryesore të cilat na dallojnë janë: kreativiteti, kompetenca si dhe njohja e mirë e tregut.

Produktet e Manaxhimit të Likuiditeteve

Gjatë vitit 2017, njësia e produkteve ka qenë e fokusuar në dixhitalizimin e produkteve dhe shërbimeve të Manaxhimit të Likuiditeteve.

Raiffeisen ka vazhduar të jetë një partner besnik për klientët e bankës duke ofruar shërbime të dedikuara sipas kërkesave specifike të tyre, në mënyrë që biznesi të optimizojë kryerjen e pagesave të tyre dhe të përmirësojë manaxhimin e parave.

Vlej për tu përmendur zhvillimi dhe përmirësimi në kanalet elektronike.

Gjatë vitit 2017 u lançua në shërbim të klientëve platforma dixhitale 'Raiffeisen ON', e cila solli një risi në procesimin dhe menaxhimin e shërbimeve në formë elektronike.

Platforma jonë e re dixhitale Raiffesien ON është një zgjidhje web dhe mobile, sistemi i ri është i sigurt dhe i lehtë për t'u përdorur, ndërsa ofron gamë të plotë të shërbimeve bankare në internet që e bëjnë jetën tuaj më të lehtë.

Platforma u projektua posaçërisht për të kursyer kohë, përpjekje dhe para për konsumatorin në menaxhimin e financave të biznesit të tyre.

Platforma elektronike 'Raiffeisen ON' është 24/7 dhe përditësimi i balancave dhe ekzekutimi i pagesave janë në kohë reale. Ajo që është më e rëndësishmja, komisionet e pagesave do të jenë preferenciale dhe të diferencuara. Asnjë produkt konkurrent në tregun vendas nuk kalon apo ofron mundësi veprimi lidhur me karakteristikat, lehtësisë së përdorimit dhe çmimit të Raiffeisen ON për bizneset. Ju mund të futeni dhe përdorni platformën elektronike të re nga smartfoni, tabletët, laptopët ose kompjuterin tuaj desktop, pasi zgjidhja jonë e re funksionon në të gjitha pajisjet tuaja.

Zhvillimi i Biznesit Korporatë dhe Bizneseve të Vogla

Objekti kryesor i njësisë së zhvillimit të biznesit korporatë dhe bizneseve të vogla ka qenë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe rritja e eficientës së proceseve për korporatat dhe bizneset e vogla, duke vendosur punonjës të përkushtuar për biznesin në degët kryesore të bakës.

Me qëllim për t'u garantuar klientëve tanë një shërbim profesional dhe në lartësinë e duhur, trainime dhe këshillime të vazhdueshme janë ndërmarrë nga njësia jonë. Gjithashtu në kuadër të procesimit të shpejtë dhe ofrimit të shërbimeve sa më cilësore, proceset tona të brendshme janë rishikuar për të qenë sa më të thjeshta dhe efçente.

Gjithashtu, "zëri i klientit" është në vëmendje të vazhdueshme nga ana jonë duke dëgjuar dhe administruar me përkushtim, çdo ankesë të mbërritur nga klientët tanë. Ky proces për ne ka një vlerë të shtuar, pasi jo vetëm na ndihmon ti ofrojmë zgjidhje klientëve për problematikat e hasura por njëkohësisht na ndihmon të përmirësojmë shërbimet dhe proceset tona në të ardhmen.

Udhëheqje



Retail Banking

Zhvillimi i Segmenteve të Klientëve

Segmenti i Klientëve Individë

Përfaqsa gjithëpërfshirëse e klientëve ka vijuar edhe këtë vit duke forcuar marrëdhënien dhe duke rritur aktivitetin e tyre me bankën. Raiffeisen Bank ka rritur bazën e klientëve pagamarrës kryesisht për shkak të formalizimit të mëtejshëm të sektorit privat të ekonomisë, duke treguar se banka jonë është e konsiderueshme në treg. Si e tillë, banka ka arritur të rrisë peshën e klientëve pagamarrës në sektorin publik me 7 përqind, edhe pse në një mjedis sfidues dhe me konkurrencë të lartë. Gjithashtu ka pasur një rritje të lehtë në bazën e klientëve pagamarrës të sektorit publik në të cilin banka është kryesuese.

Klientët individë kanë rritur aktivitetin e tyre ditore me bankën dhe kjo ndihmoi që të rriteshin të ardhurat nga tarifat dhe komisionet, duke e përmirësuar raportin komisione/të ardhura me 26 përqind nga 20 përqind krahasuar me vitin e kaluar.

Në datën 31.10.2016, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare liçenoi Raiffeisen Bank për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime për klasat e Jetës dhe të Jo-Jetës. Nëpërmjet stafit të bankës të liçencuar si broker fizik, do të kryhet veprimtaria e brokerimit në sigurime, në emër dhe për llogari të Raiffeisen Bank.

Duke përdorur rrjetin ekzistues të degëve dhe forcën aktuale shitëse, aktiviteti i brokerimit për produktet e sigurimit që filloi të zhvillohet në kuadër të kësaj liçence, kontribuoi në rritjen e të ardhurave të Retail me 10 përqind gjatë vitit 2017.

Një risi gjatë vitit 2017-të ka qënë integrimi i teknologjisë biometrike në dhjetë degë të Raiffeisen Bank. Identifikimi biometrik i klientëve është prezantuar si projekt pilot që në janar 2016 në degën "Abdyl Frashëri" në Tiranë dhe më pas është aplikuar në dhjetë degë të tjera në vend. Sipas këtij inovacioni, identifikimi i individëve bëhet nëpërmjet shenjës së gishtit, si tipar unik biologjik. Unikiteti biometrik siguron saktësinë optimale në identifikim, duke përfituar korrektësi në identifikimin e klientëve me qëllim parandalimin e veprimeve të paligjshme dhe mashtrimin në transaksionet bankare.

Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientët (CRM) është një aktivitet themelor në biznesin Retail, ku banka synon të zhvillojë klientët e vet në marrëdhënie më produktive dhe përfituese për të gjitha palët. Përpunimi i të dhënave të avancuara mundëson ofrimin e ofertave më të përshtatshme për klientët, duke u ofruar atyre mundësi më kuptimplote dhe duke rritur përdorimin e produkteve dhe shërbimeve të bankës sonë.

Fillimi i Raiffeisen ON, platforma e re bankare dixhitale e bankës, ishte një sukses i madh në drejtim të përshtatjes dhe përdorimit të konsumatorëve. CRM u përdor për të kuptuar sjelljen e abonentëve individë në këtë platformë, duke lejuar bankën të kontaktojë dhe të ndihmojë abonentët e rinj në mënyrë që të përfitojnë më shumë nga këto shërbime të avancuara bankare.

Segmenti Premium

Banka Raiffeisen udhëheq tregun bankar në shërbim të avancuar të klientëve më të mirë që prej fillimit të segmentit Premium, në vitin 2010.

Aktualisht banka ka mbi 13'250 klientë në segmentin Premium me kërkesa të ndryshme bankare, duke filluar nga kërkesat primare e deri tek kërkesat më komplekse, të cilat kërkojnë këshillim të plotë financiar. Janë dy nivele në Premium Banking:

- Klientët Classic, të cilët përfitojnë një shërbim të veçantë nga personel me shumë eksperiencë në degë;
- Klientët Club të cilët përfitojnë shërbimi më të veçantë dhe më të specializuar, i cili ofrohet për klientë me të ardhura tepër të larta.

Klientët Premium Club shërbehen në zona private në degë nga Menaxherët e Dedikuar për Premium. Menaxherët e Dedikuar për Premium janë të lokalizuar në 15 degë në qytetet më të mëdha të vendit dhe ata jo vetëm që ofrojnë një shërbim të personalizuar, por janë të trajnuar edhe në këshillimin financiar.

Strategjia e segmentit Premium është që të rritet më tepër në kredithënie dhe në transaksione duke kontribuar në rritjen e të ardhurave. Për 2017, segmenti Premium u rrit me 14 përqind krahasuar me një vit me parë.

Segmenti Premium është i ofron klientëve të saj nivelet më të larta të menaxhimit dhe shërbimit.

Segmenti i Bizneseve Mikro


Raiffeisen Bank Sh.a gëzon tashmë një eksperiencë tetë vjeçare në shërbimin e biznesit Mikro, duke ofruar një linjë të plotë shërbimesh profesionale për këtë segment. Ky segment është fokusuar në tërheqjen e klientëve të rinj nëpërmjet programeve të veçanta duke u ofruar klientëve të saj një linjë prej tre paketash shërbimesh përmes të cilave klientët mund të zgjedhin atë që i përshtatet më shumë nevojave të biznesit të tyre.

Vlera që ky segment ofron është një kombinim i produkteve konkurruese dhe shërbimi të dedikuar, duke ofruar një partneritet solid dhe shërbim të dedikuar konsulence mbi nevojat e menjëhershme ose të ardhshme të bizneseve Mikro, duke ruajtur gjithnjë standarde të larta të shërbimit. Ky segment vazhdon të investojë në zhvillimin e forcës shitëse të dedikuar për këtë segment, të cilët janë shpërndarë në degët kryesore të qyteteve më të mëdha në Shqipëri.

Viti 2017 rezultoi me përafërsisht 5,300 kliente të rinj, të cilët mundësuan rritjen e bazës së klientëve në 26,500 klientë. Portofoli i Aseteve të Segmentit Mikro deri në fund të vitit 2017 ishte 9 milionë Euro, ndërkohë që portofoli i Pasiveve arriti 70 milionë Euro.

Gjatë vitit 2018, segmenti i biznesit Mikro do të vazhdojë të fokusohet në rritjen e pjesëmarrjes në treg nëpërmjet tërheqjes së klientëve të rinj aktivë, rritjes së marrëdhënieve me klientët primarë dhe ofrimit të marrëdhënieve të cilësisë së lartë fokusuar tek kreditimi.

Volum i Aktiveve, Pasiveve dhe Numri i Klientëve
Janar - Dhjetor 2017



Divizioni i Produkteve

Depozitat me Afat dhe Produktet e Kursimit

Gjatë vitit 2017 depozitat e klientëve individë vazhuan të zinin zërin kryesor në bilancin e bankës.

Normat e tregut shënuan nivelin më të ulët në vitin 2017, për shkak edhe të likuiditetit të tepërt në sistemin bankar. Si

rrjedhojë, normat e interesit për depozitat me afat vijuan të ulen në mënyrë të ndjeshme. Raiffeisen Bank i ka ofruar klientëve të saj mundësi alternative për mënyrën e manaxhimit dhe investimit të pasurisë, nëpërmjet kompanisë bijë të saj Raiffeisen Invest, e vetmja kompani lider në Shqipëri e cila ofron mundësinë e investimit të fondeve për publikun. Pjesa më e madhe e klientëve ka vazhduar të besojë në bankën tonë duke i mbajtur depozitat e tyre pranë nesh, pavarësisht normave të ulëta të interesit që ofrohen. Një pjesë e mirë e klientëve tanë kanë zgjedhur të investojnë kursimet e tyre në fondet e ofruara nga Raiffeisen Invest, duke përfituar kështu të ardhura vjetore të mira, më të larta se depozitat me afat të ofruara në treg.

Fondet e Investimit të Raiffeisen Invest, të cilat ofrohen në të gjithë rrjetin e degëve Raiffeisen, kanë tërhequr gjithashtu klientë të rinj si forma të reja investimi. Kombinimi i produkteve tradicionale të kursimit në Raiffeisen Bank me fondet e ofruara nga Raiffeisen Invest, i jep klientëve individë më tepër mundësi zgjedhjeje për të menaxhuar të ardhurat e tyre.

Kreditë për Individë

Gjatë vitit 2017 Raiffeisen Bank ka vazhduar t'i kushtojë rëndësi të veçantë Kredisë për Individë duke rritur portofolin, duke u përqëndruar tek klientët e rinj dhe duke promovuar avantazhet konkurrese të produkteve të kredisë ndërkohë që tregu është nën ndikimin e normave të ulëta të interesit. Portofoli i kredisë u rrit në 204 milionë Euro, rezultati më i lartë i 11 viteve në kredidhënie. Në këtë mënyrë, prania e Raiffeisen Bank në tregun bankar të kredidhënies për individë u rrit në 18 përqind.

Kreditë Konsumatore ishin nxitësi kryesor i rritjes së portofolit të kredive për individë gjatë vitit 2017, pasi edhe kërkesa për këto tipe kredie në tregun shqiptar vazhdon të qëndrojë e lartë. Kërkesa e lartë, e shoqëruar nga fushata të ndryshme marketingu, të cilat kanë promovuar një varietet të gjerë normash fikse interesi, ka bërë që shitjet për kreditë konsumatore të rriten me 11 përqind gjatë 2017 duke arritur një portofol prej 104 milionë Euro.

Raiffeisen Bank i ka dhënë prioritet të veçantë kredive hipotekare nëpërmjet fushatave të ndryshme promovionale, të cilat kanë synuar të promovojnë kushte pune shumë të favorshme gjatë gjithë vitit. Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2017 Raiffeisen Bank ka nisur me shumë sukses një program të rëndësishëm në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. Programi ka pasur performancë shumë të mirë për kreditë hipotekare ku në vetëm tre muaj është arritur 27 përqind e shitjeve vjetore duke rritur në këtë mënyrë edhe prezencën e Raiffeisen Bank në tregun e kredive hipotekare në 10 përqind.

Viti 2018 pritet të jetë një tjetër vit i sukseshëm. Raiffeisen Bank pret arritje shumë të rëndësishme gjatë vitit 2018. Në qendër të vëmendjes do të vazhdojë të jetë rritja e portfolit të kredisë për individë, programi i kredive hipotekare me Bashkinë e Tiranës si dhe fushatat e ndryshme promovuese. Një rol shumë të rëndësishëm në strategjinë e rritjes do të ketë edhe zhvillimi kredidhënies nëpërmjet kanaleve dixhiale si një mundësi e jashtëzakonshme për të qenë më pranë klientëve individë.

Transferta

Me prezantimin e platformës së re dixhitale Raiffeisen ON komisionet për pagesat dhe transaksionet në arkë u rishikuan, në mënyrë që të reflektonin shtimin e transaksioneve në platformën e re dhe për të monitoruar aktivitetin e pagesave në degë. Përmirësime të mëtejshme u bënë gjithashtu dhe në procesimin e pagesave në degë dhe ato në drejtori.

Si rezultat përdorimi i Raiffeisen ON u rrit gradualisht si për veprimet me klientët individë ashtu dhe ata mikro, respektivisht 64 përqind dhe 20 përqind të pagesave të tyre u kryen nëpërmjet mobile banking dhe internet banking. Po kështu komisionet për Retail u rritën me 21 përqind dhe volumet e parave ranë me 8 përqind krahasuar me një vit më parë.

Divizioni i Biznesit me Karta dhe Bankingut Elektronik

Biznesi i Kartave

Rezultatet e vitit 2017 për Raiffeisen Bank, tregojnë një rritje të qëndrueshme në biznesin e kartave. Numri i klientëve të rinj për produktin e kartave të kreditit u rrit me mbi 22 përqind në krahasim me vitin 2016. Në të njëjtën kohë, klientët e kartave të kreditit kryen më tepër transaksione plus 27 përqind duke reflektuar një tendencë në rritje të pagesave elektronike si dhe reduktim të pagesave në para. Kjo është ndikuar kryesisht prej perpjekjeve tona në drejtim të edukimit dhe ndërgjegjësimit të klientëve si dhe fushatave "cash-back" të realizuara gjatë vitit 2017.

Raiffeisen Bank konstaton një rritje të ndjeshme edhe në përdorimin e kartave të debitit. Numri i transaksioneve të kryera me karta debitit në ATM dhe Pika Shitjeje/POS u rrit me 13 përqind me një rritje të ndjeshme në transaksionet e blerjes me kartë me 58 përqind krahasuar me vitin 2016 duke konfirmuar që tregu është duke fuqizuar pagesat elektronike çdo ditë e më tepër.

Rrjeti i Pikave të Shitjes/POS

Raiffeisen Bank është një bankë konkurruese në tregun shqiptar në këndvështrimin e performancës dhe cilësisë së biznesit të pranimit të pagesave me karta nëpërmjet Pikave të Shitjes/POS, me një prezencë në kategoritë kryesore të tregtarëve si super-markete dhe qendra tregtare, hotele, agjenci udhëtimi, dyqane, restorante, pika karburanti etj.

Në vitin 2017 Raiffeisen Bank vijoi me implementimin e masave për të përmirësuar përfitueshmërinë e rrjetit të pikave të shitjes /POS gjë që konfirmohet lehtësisht nga rritja me 21 përqind e transaksioneve të kryera nëpërmjet rrjetit tonë të Pikave të Shitjes/POS.

Pranimi i pagesave me karta nëpërmjet Internetit / Shërbimi E-Commerce

Raiffeisen Bank vijon të jetë lider në tregun shqiptar në shërbimin E-Commerce edhe për vitin 2017, ky shërbim është zgjeruar edhe për disa lloje të tjerë tregtarësh si OJF dhe fondacione të tjera.

Teknologjia 3-D Secure ofron standardin më të avancuar për sigurinë e pagesave në procesin e shitjes. Kjo është reflektuar në rritjen e numrit të transaksioneve me 25 përqind përgjatë 2017 si dhe me uljen tepër të ndjeshme të reklamimit të transaksioneve nëpërmjet shërbimit tonë E-Commerce.

Rrjeti ATM

Me qëllimin e rritjes së efektivitetit të rrjetit të ATM-ve, Raiffeisen Bank u fokusua tek strategjia e saj për optimizimin e rrjetit duke rialokuar ATM-të pranë zonave me trafik të lartë si dhe duke hequr nga tregu ATM-të e vjetra dhe me përdorim të ulët. Shërbimi i ATM-së ofrohet për të gjitha kartat e lëshuara në gjithë botën nën logon VISA, VISA Electron, PLUS, MasterCard, Maestro dhe Cirrus.

Banka ka ulur numrin e ATM-ve që ofronin shërbimet në monedhën Euro nga 44 ATM në vetëm 8 ATM të vendosura në zonat turistike, qendra tregtare dhe zonat kyçe të qyteteve kryesore.

Kjo iniciativë është në përputhje me strategjinë e Bankës së Shqipërisë dhe qeverisë shqiptare kundër tendencës së euroizimit të fortë të tregut dhe ekonomisë sonë.

Banka prezantoi funksionalitetin e ri të depozitimit të parave në ATM. Janë 28 ATM që ofrojnë depozitimin e parave për të gjithë kartëmbajtësit e Raiffeisen Bank. Ky shërbim është mirëpritur nga klientët tanë si një alternativë tepër e përdorshme përkundëjt depozitimeve në degë duke shënuar një rritje të shpejtë të depozitimeve pranë ATM-ve. Një shërbim i tillë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të Raiffeisen Bank për të rritur mundësitë dhe për të përdorur kanalet elektronike bankare me mundësi përdorimi 24/7 në qendrat tona të vetë shërbimit.

Bankingu dixhital

Banka Raiffeisen krenohet me pozicionin e saj si drejtuese e tregut në inovacion dhe ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në rritjen e numrit të produkteve dhe shërbimeve që mund të ofrohen në kanalet e saj të bankingut dixhital. Në përputhje me strategjinë e saj të dixhitalizimit, në mars 2017, Banka Raiffeisen zhvilloi një platformë të re të bankingut dixhital me teknologjinë më të fundit, e quajtur Raiffeisen ON, për t'i shërbyer të gjithë segmenteve të klientëve të saj (Individë, Biznese të Vogla dhe të Mesme dhe Korporata) duke i mundësuar atyre të kryejnë veprime në mënyrë të njëjtë në të gjitha paisjet. Kjo platformë është pjesë e një ekosistemi më të gjerë e bankingut dixhital që do të transformojë mënyrën sesi klientët tanë bëjnë banking. Ky ekosistem do të rrisë në mënyrë të konsiderueshme komoditetin e klientëve dhe lehtësinë në përdorimin e çdo kanali të bankingut dixhital, ndërkohë do të optimizojë edhe uljen e kostove operative të bankës.

Gjatë vitit 2017, numri i klientëve që u regjistruan në Raiffeisen ON e tejkaloi me 10 përqind krahasuar me peshën në numrin e klientëve individë aktivë dhe me 19 përqind krahasuar me bizneset aktive mikro. Në nëntë muajt e parë jo vetëm që numri i regjistrimeve u rrit me peshë të konsiderueshme në klientët e bankës, por çdo muaj $\frac{3}{4}$ e këtyre klientëve hynin për të parë llogaritë e tyre dhe të kryenin veprime online.

Raiffeisen ON, ofron një numër të madh funksionalitetesh duke filluar nga vetë-regjistrimi i klientit individ online dhe aktivizimi shërbimit, deri tek kontrolli i historikut të detajuar të veprimeve, dhe e drejta të shkarkimit të nxjerrjeve për çdo llogari, etj. Gjithashtu, klientët mund të kryejnë online pagesa të faturave mujore, taksave të ndryshme, kartës së kreditit dhe transfertat drejt palëve të treta brenda bankës, branda vendit apo jashtë vendit në kohë reale përsa i përket procesimit të pagesës dhe rifreskimit të informacionit mbi gjendjen e llogarisë. Shërbimi i bankingut dixhital mbështetet me hyrje dhe suport në çdo kohë 24/7, dhe mbrohet me teknologjinë më të fundit të sigurisë.

Pagesat

Numri i Pagesave dhe Transfertave të kryera nga klientët Individë, Premium dhe Mikro ka patur rritje prej 9 përqind gjatë 2017 krahasuar me vitin paraardhës. Pagesat e kryera nga kanalet elektronike arritën në 41 përqind dhe pritet që me këtë tendencë, të rriten akoma më tepër përgjatë vitit 2018.

Kanalet e Shpërndarjes

Divizioni i Shitjeve dhe Kanaleve të Shpërndarjes, në linjë me platformën e re dixhitale të prezantuar në 2017, u fokusua në qendrat e vetëshërbimit bazuar në kapacitetet e degëve më të mëdha, që të plotësonin shërbimin e ofruar në degë. Pesë degë të tjera u pajisën me shërbimin e depozitimit në ATM “Cash IN”, që i ofron klientëve mundësi më të përshtatshme dhe më të shpejta për depozitimin e parasë 24 orë në ditë 7 ditë në javë, dukë lehtësuar trafikun e klientëve në degë për një shërbim përgjithësisht më të mirë. Në fillimin e 2018, do të shtohen kioskat dixhitale vetëshërbim, duke i mundësuar klientëve përdorimin e Raiffeisen ON nëpërmjet kartës së debitit dhe kreditit dhe PIN-it të kartës, për të kontrolluar llogaritë, të kryejnë pagesa dhe transfera në çdo moment. Kjo do t'i mundësojë klientëve që të kuptojnë avatazhet e shërbimit bankar dixhital Raiffeisen ON me qëllim që të regjistrohen për shërbimet e Internet Banking, nga të gjitha pajisjet e tyre elektronike.

Në Tiranë, u realizua hapja e një agjencie pilot, si një qendër për transaksionet e shpejta ditore, e quajtur Zona Express. Gjithashtu, disa degë të mëdha u zgjeruan dhe rinovuan me qëllim ruajtjen e shërbimit të shkëlqyeshëm në degë. Dega e Shkodrës, më e madhja në Distriktin Verior, pothuajse dyfishoi hapësirën e saj, me shtimin e një kati dhe riorganizimin total të hapësirës. Në Tiranë u krye zhvendosja e një dege në zonën me zhvillim të lartë të Unazës së Re. Këto projekte zhvillimore janë pjesë e transformimit të rrjetit të degëve që do të vazhdojë edhe gjatë 2018. Qëllimi është modernizimi i bankikut në Shqipëri duke ofruar shërbime dixhitale të fjalës së fundit dhe shërbim superior në degë për nevoja dhe transaksione më komplekse.

Optimizimi i rrjetit vazhdoi gjatë gjithë vitit 2017, duke reduktuar rrjetin e degëve me 3 njësi për të përmirësuar efektivitetin e kostove, duke ruajtur sërish rrjetin më të madh në Shqipëri, me 76 degë.

Përsa i përket Manaxhimit të Shitjeve dhe Shërbimit, kemi pasur 2 arritje kryesore gjatë 2017.

Trajnimi i drejtuesve të degëve dhe agjencive kaluan me sukses nivelin profesional të programit ndërkombëtar të trajnimit të Akademisë së Manaxhimit të Degëve (BMA), duke përmirësuar aftësitë e tyre drejtuese dhe manaxhuese.

Lean në Degë, një program i plotë për të bërë procedurat dhe aktivitetet më efektive. Janë zbatuar shumë ndryshime dhe përmirësime të identifikuara nga ekipi i Lean dhe nga stafi i degëve. Funkcionimi më efektiv në degë, mundëson një shërbim të përmirësuar ndaj klientit.

2017 ishte një vit i mirë për përsa i përket aktiviteteve të shitjes jashtë ambienteve të degëve. Pjesa e kontributit total të Shitjeve Direkte dhe Financimit të Shitjeve Retail të totalit të kredive të pasiguruara, u rrit në 26 përqind. Financimi i Shitjeve Retail vazhdon të kontribuojë tek të ardhurat me marzhe të larta dhe cilësi të shkëlqyer portofoli. Shitjet janë rritur me 20 përqind krahasuar me një vit më parë.

Aplikacioni inovativ “Shtëpia Ime” (My Home), i cili mbështet blerësit e shtëpive që të gjejnë online shtëpi për shitje, e pozicion bankën jo vetëm si një bankë që financon shtëpitë e blera, por si një këshillues dhe mbështetës për klientin gjatë kësaj periudhe të rëndësishme në jetët e tyre. Në 2018, aplikacioni do të vazhdojë të zgjerohet për të mbështetur klientët në një proces të plotë të blerjes së shtëpisë. Marrëdhëniet nga kjo qasje, po kontribuojnë gjithnjë e më shumë në kredi për blerje shtëpie.

Në biznesin Mikro, manaxherët e marrëdhënieve vazhdojnë të punojnë me një bazë më të madhe klientësh, që u zgjerua me më shumë se 70 përqind gjatë 3 viteve të fundit. Të ardhurat janë rritur ndjeshëm në 2017. Bankingu Premium, një program unik i cilësisë së lartë i manaxhimit të marrëdhënieve për klientët më të mirë, u përmirësua me shumë nëpërmjet një programi të ri të manaxhimit të marrëdhënieve.

Planet për 2018 përfshijnë transformimin e vazhdueshëm të rrjetit të degëve, me shtimin e funksionaliteteve të bankikut dixhital, me më shumë zona të rehatshme për vetëshërbim apo zona ekspres, eksperiencë të përmirësuar në degë si dhe trainim i vazhdueshëm i stafit tonë me qëllim që t'i japim klientëve një eksperiencë të shkëlqyer, gjithmonë në rritje.



Shpirt Skuadre

Thesari dhe Bankingu i Investimeve

Të Ardhurat Fikse

Portofoli ynë ka vazhduar të jetë në të njëjtin nivel si një vit më parë, ku struktura është ruajtur po ajo që ka qenë me një përqëndrim pak më të lartë në obligacione thesari, veçanërisht ato me maturim dy vjeçar. Gjatë vitit 2017 portofoli ynë u pasuria me obligacione të emetuara në euro nga institucione ndërkombëtare financiare me risk të ulët dhe me të ardhura më të larta se sa investimet në euro në tregun e parasë. Këto investime kanë gjeneruar dhe pritjet gjithashtu në vitet në vazhdim të gjenerojnë të ardhura shumë të mira nga interesi.

Strategjia jonë e portofolit të letrave me vlerë, kryesisht ato në lekë, është konform dhe në ndikim të vazhdueshëm të kuadrit rregullator të Bashkimit Evropian dhe institucioneve rregullatore të tij. Veçanërisht aktivat e konsideruara me risk të lartë, kanë ndikuar vazhdimisht edhe investimet tona. Pikësynimi ynë ka qenë mbajtja në nivel të caktuar të investimeve tona duke qenë në linjë edhe me rregullatorët dhe institucionet vendase si dhe ato evropiane.

Viti 2017 ishte një vit sfidues me norma interesi që pavarësisht në nivele pak më të larta se viti tjetër ishin përsëri më të ulta se pritshmëritë tona duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në portofolin e investimeve. Njësia e të ardhurave fikse u fokusua kryesisht në investime të mbajtura në maturim, duke respektuar çdo lloj rregulli apo limiti. Manaxhimi i investimeve të reja dhe ekzistuese prodhuan një rezultat të lartë të të ardhurave nga interesi për portofolin e investimeve në maturim. Por nga ana tjetër rritja e yield-ëve të letrave me vlerë në tregun primar krahasuar me vitin 2016 ndikuan në vlerën e tregut të portofolit të tregtueshëm.

Përgjatë gjithë 2017 kemi vijuar të jemi aktiv në tregun me pakicë dhe atë sekondar të letrave me vlerë. Kemi patur si qëllim të rrisim dhe diversifikojmë mundësitë dhe alternativat e investimeve për klientët tanë, duke ju ofruar letra me vlerë të maturimeve të ndryshme. Prandaj mund të themi që jemi krenarë sepse vazhdojmë të jemi kontribuesit kryesorë në tregun sekondar të bonove dhe obligacioneve të thesarit, duke i tregtuar ato në degët tona në të gjithë vendin. Gjatë vitit 2017 numri i transaksioneve të letrave me vlerë të tregtuara në tregun sekondar dhe me pakicë kanë vijuar të jenë të larta edhe të ardhurat e gjeneruara nga këto transaksione kanë qenë në nivele të kënaqshme. Banka jonë vijoi të kryente aktivitetin e kujdestarit të letrave me vlerë të emetuara nga qeveria e Shqipërisë duke mundësuar investitorët e huaj dhe ata vendas të marrin pjesë në tregun tonë.

Tregu i Parasë

Njësia Tregut të Parasë, si një njësi aktive, ka dhënë kontributin e saj për të arritur objektivin e saj kryesor, fitim e të ardhura nga rezervat e saj dhe për të ruajtur likuiditetin në nivele optimale në mënyrë që të përmbushen kërkesat për tërheqje të papritur të fondeve nga depozituesit. Njësia e Tregut të Parasë së Raiffesien Bank ka dhënë kontributin e saj në zhvillimin e aktivitetit ndërbankar vendas dhe ka patur një rol kryesor në politikën monetare të Bankës Qendrore.

Likuiditeti i Bankës për vitin 2017 ka qenë në nivele të konsiderueshme, dhe ka qenë një vit i suksesshëm sa i takon manaxhimit të kësaj teprice brenda të gjitha limiteve të disponueshme. Mbështetur në besimin e klientëve tanë në sistemin financiar, dhe sidomos në Raiffeisen Bank, likuiditeti i bankës për vitin 2017 ka mbetur në nivele qëndrueshme. Portofoli i Tregut të Parasë gjatë gjithë vitit 2017 ka qenë i mirëmanaxhuar dhe maturitetet kanë qenë të ndryshme, me qëllim përmbushjen e rregullores të Bankës Qendrore në lidhje me ekspozimin e bankës ndaj bankave të mëdha. Njësia e Tregut të Parasë ka respektuar të gjitha kufizimet në limite, gjithmonë duke përmbushur nevojat e bankës në çdo moment për likuiditet në çdo monedhë.

Pavarësisht të gjithë zhvillimeve dhe sfidave të tregut gjatë vitit 2017, Njësia e Tregut të Parasë ka bërë përpjekjet maksimale për të manaxhuar me sukses likuiditetin afatshkurtër, dhe duke realizuar kështu një performancë të mirë në një mjedis sfidues sa i takon normave të interesit, të cilat janë në rënie të vazhdueshme.

Për shumë vite tashmë, si pjesë aktive dhe e domosdoshme e një tregu ende në zhvillim lokal, njësia e Tregut të Parave, kontribuon çdo ditë për botimet e TRIBOR / TRIBOR. Këto kuotime janë një aspekt shumë i rëndësishëm i zhvillimit të tregut lokal, pasi reflektojnë aktivitetin e saj, dhe TRIBID / TRIBOR janë gjithashtu një çështje e rëndësishme në parashikimin dhe interpretimin e situatës së likuiditetit të tregut.

Këmbimet Valutore

Viti 2017 është karakterizuar nga një tendencë rritëse e kuotimit EUR/USD të ndikuara kryesisht nga Politika Monetare e Bankës Qendrore Amerikane dhe të dhënat ekonomike të cilët kanë bërë që Euro të konsiderohet si monedhë më e sigurt. Monedha Europiane është vlerësuar me 16 përqind më tepër përkundrejt dollarit amerikan duke arritur nivelin e 1.2000.

Njësia e Këmbimeve Valutore ka manaxhuar me kujdes pozicionin valutor dhe riskun që lidhet me të duke u bazuar në analiza profesionale të tregjeve financiare duke mbyllur vitin me një rezultat shumë të mirë.

Monedha vendase ka ndjekur tendencën rritëse përkundrejt monedhës Europiane dhe Dollarit Amerikan kryesisht gjatë sezonit të verës dhe fund vitit duke u kuotuar me 131.98. Forcimi i Lekut është ndikuar nga një tepricë e likuiditetit në Euro në tregun Shqiptar për rrjedhojë të investimeve të huaja dhe efektet e ofertë – kërkesës.

Banka e Shqipërisë ka organizuar në mënyrë periodike ankande për blerjen e monedhës Europiane për të rritur rezervën valutore dhe Raiffeisen Bank ka marrë pjesë dhe ka fituar në shumicën e rasteve.

Dollari Amerikan ka ndjekur të njëjtin trend si në tregun ndërkombëtar dhe është zhvlerësuar me 17 përqind përkundrejt monedhës vendase duke arritur nivelin më të ulët prej 110.43.

Njësia e Këmbimit Valutor ka dhënë mbështetjen e saj maksimale në tregun lokal me mbajtjen e një kuotimi konkurrues në ofertë / kërkesën në tregun ndërbankar dhe me klientët.

Volumet e veprimeve të këmbimit valutor kanë vazhduar të jenë të larta veçanërisht në veprimet EUR/USD, në nivelet e 200 milionë Euro në muaj.

Njësia e Shitjeve

Gjatë vitit 2017 njësia e shitjeve të thesarit realizoi shumë mirë aktivitetin tregtar duke ju ofruar klientëve produkte shumë konkurruese të thesarit dhe duke mbyllur vitin me një rezultat të lartë.

Në fokus të tyre qëndron gjithmonë përmbushja e nevojave të klientëve në përputhje me politikat dhe strategjitë e bankës. Ky rezultat i mirë është arritur në sajë të një stafi të dedikuar dhe në bashkëpunim me të gjitha kanalet e biznesit të Raiffeisen Bank.

Departamenti i Shitjeve të Thesarit ka vazhduar të jetë lider në tregun financiar shqiptar duke ofruar çmimet më konkurruese në treg.



Strategji



Përgjegjësia Sociale e Korporatës

Raiffeisen Bank në Shqipëri mbetet e përkushtuar ndaj Përgjegjësisë Sociale të Korporatës duke synuar të kontribuojë në qëndrueshmërinë dhe përmirësimin e kushteve sociale, shëndetësore dhe mjedisore të komunitetit në Shqipëri. Ne besojmë se japim më të mirën kur kombinojmë forcën e biznesit tonë me dëshirën për ti shërbyer komunitetit ku veprojmë.

Në këtë kuadër, kontributi i Raiffeisen Bank në fushën e arsimit ka qenë i konsiderueshëm dhe konsistent gjatë gjithë vitit duke mbështetur projekte arsimore për shkollat e mesme në vend ashtu edhe për universitetet. Ky kontribut ka qenë pajisje me kompjutera apo mbështetje e aktiviteteve të ndryshme, të cilat synojnë zhvillimin dhe përmirësimin e njohurive të nxënësve si dhe ndihmojnë në zhvillimin e një procesi mësimor cilësor. Projekte të rëndësishme në këtë fushë kanë qenë "Dita e Hapur" me Universitetin e Filologjisë apo Konferenca e Financës me Fakultetin e Ekonomisë, etj.

Gjithashtu, projekte të tjera të rëndësishme të cilat Raiffesien Bank ka mbështetur janë rikonstruksioni i ambjentëve të jashtme të shkollës së Bilishtit apo pajisja e shkollës së baletit në Tiranë me kamerat e sigurisë. Më tej, ka vijuar edhe këtë vit projekti "Qyteti i lexuesve" në bashkëpunim me Bashkitë Lushnje dhe Divjakë për pajisjen me libra të bibliotekave të këtyre qyteteve. Ky projekt ka pasur një ndikim mjaft pozitiv, sepse ka rritur ndjeshëm numrin e lexuesve në këto qytete dhe kjo falë mbështetjes së Raiffeisen Bank.

Raiffeisen Bank në Shqipëri ka vijuar më tej mbështetjen ndaj sektorit të shëndetësisë, si një sektor mjaft i rëndësishëm dhe që kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së komunitetit. Këtë vit ne kemi mbështetur mjaft projekte për spitale dhe institucione të ndryshme të shëndetit publik, ku nga kontributet më të spikatura ishte ai për rikonstruksionin e Repartit të Kardiologjisë në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës "Nënë Tereza".

Raiffeisen Bank ka dhënë si çdo vit kontributin e saj në projektet me ndikim social. Një traditë e mirë tashmë është bërë mbështetja e projekteve për të ndihmuar fëmijët me autizëm apo aktivitete ndërgjegjësimi për fëmijët me Sindromën Down. Gjithashtu si çdo vit kemi mbështetur aktivitetin me karakter social Gjymnastura Shqiptare që synon edukimin e fëmijeve nëpërmjet artit dhe sportit si dhe integrimin e fëmijëve në nevojë në shoqëri nëpërmjet përfshirjes në këto aktivitete.

Më tej, këtë vit kemi mbështetur edhe aktivitete që vlejnë të përmenden dhe që përkrahin promovimin e turizmit shqiptar siç ishte South Outdoor Festival në Himarë, që rezultoi mjaft i sukseshëm në edicionin e tij të parë dhe Festivali Multikulturor në Berat, i cili promovon zonën dhe Iso-polifoninë popullore.

Projektet për mbrojtjen e mjedisit kanë gjetur gjithashtu mbështetjen e Raiffeisen Bank. Këtu mund të përmendim projektet për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytetin e Vlorës falë bashkëpunimit me Bashkinë e këtij qyteti apo ndërtimi i këndeve të lojrave dhe parqeve për fëmijë në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. Gjithashtu, falë bashkëpunimit të vazhdueshëm me Bashkinë e Tiranës kemi mbështetur projektin e pajisjes me stola të Sheshit Skënderbej si dhe Maratonën e Tiranës, dy projekte këto me ndikim mjaft pozitiv në kryeqytet.

Kultura është një tjetër sektor i rëndësishëm për shoqërinë, dhe ne në Raiffeisen Bank kemi dhënë kontribut të rëndësishëm me qëllim rritjen e ndikimit të artit dhe kulturës në shoqëri. Dëshmi e kësaj mbështetjeje është bashkëpunimi i vazhdueshëm me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Teatrin Kombëtar në shfaqjet e tyre përgjatë gjithë vitit, si dhe shumë projekte kulturore të tjera që patën një ndikim pozitiv në jetën kulturore jo vetëm në kryeqytet por në të gjithë Shqipërinë.

Raiffeisen Bank në Shqipëri, përveç ofrimit të shërbimeve dhe produkteve bankare, mbetet e përkushtuar për të kontribuar dhe mbështetur projekte që ndihmojnë komunitetin dhe përmirësimin e jetës së tij si pjesë e përgjegjësisë së saj sociale.

Burimet Njerëzore

Me një staf prej 1.277 punonjës, Raiffeisen Bank është një nga punëdhënësit më të fuqishëm dhe më të mirë në Shqipëri, duke krijuar një mjedis konkurrues përsa i përket kompensimit, zhvillimit dhe motivimit të stafit.

Rekrutimi dhe Përzgjedhja

Gjatë vitit 2017, procesi i rekrutimit dhe selektimit të stafit synoi përzgjedhjen e një stafi të kualifikuar, me eksperiencë dhe aftësi profesionale në të gjitha nivelet e shërbimit në bankë, për të mbështetur nevojat e biznesit në të gjitha fushat ku vepron.

Për të vlerësuar dhe përzgjedhur kandidatët më të mirë dhe profesionistët më të mirë në treg, ndiqet një proces rekrutimi i strukturuar prej disa fazash: atë të testeve teknike, logjike dhe/ose psikometrike si dhe testet e personalitetit. Kandidatët e përzgjedhur në këto faza bëhen pjesë e proceseve intervistuese, ku paneli është i përbërë nga supervisorët e departamentit/menaxherët të distrikteve dhe përfaqësues nga Divizioni i Burimeve Njerëzore.

Për Raiffeisen Bank fokusi kryesor mbetet promovimi dhe zhvillimi i punonjësve të saj. Kandidatët e brendshëm, në bazë të performancës së tyre, u konsideruan si potenciali kryesor për pozicionet e lira të shpallura në bankë. Kjo gjë krijon mundësi zhvillimi dhe ndërtimi të një karrierë të sukseshme brenda institucionit dhe rritjen e motivimit të brendshëm tek punonjësit.

Për të përmbushur nevojat për staf në pozicione të nivelit bazë, por jo vetëm, janë rekrutuar 72 punonjës, ku studentët në Programin e Praktikës, punonjësit me qira (leased) dhe studentët e programit DSA janë burimi kryesor për plotësimin e këtyre pozicioneve.

Programi i Praktikës

Raiffeisen Bank ka krijuar traditën e saj të programit të praktikës. Synimi i saj është të tërheqë studentë me rezultate të larta, të cilët shfaqin një nivel të lartë motivimi, vullneti dhe dëshirë për të punuar në një mjedis financiar. Banka është e angazhuar ndaj Përgjegjësisë Sociale të Korporatës dhe programi i praktikës është një element i rëndësishëm i saj. Në mirëpresim studentë nga universitetet me reputacion të lartë në të gjithë vendin, në mënyrë që ata të mësojnë në praktikë mënyrën se si funksionon Banka dhe t'i ndihmojë ata të përgatiten për tregun e punës.

Programi Studentët DSA

Programi Studentët DSA gjatë vitit 2017 ka konsoliduar bashkëpunimin midis bankës dhe shumë universiteteve në vend. Fokusi i këtij programi, i nisur nga Departamenti i Shitjeve dhe Marrëdhënive Direkte, është rritja e shitjeve të produkteve të ndryshme në degë. Studentëve të përzgjedhur, të cilët punojnë si Agjentë të Shitjeve Direkte, u ofrohet trajnim dhe mbështetje nga shitës me eksperiencë gjatë gjithë programit njëvjeçar. Në fund të programit, ata fitojnë njohuri për produktet dhe proceset bankare dhe janë kandidatë potencialë për pozicionet e lira në bankë.

Programi i Studenteve DSA ka nxitur dhe shtuar biznesin në degë si dhe ka qenë një prurje shumë e mirë edhe në burime njerëzore për qëllime rekrutimi.

Punonjës me kontratë të përkohshme nga kompani të jashtme

Edhe gjatë vitit 2017 Raiffeisen Bank, ka vijuar bashkëpunimin me një kompani të jashtme, duke punësuar punonjës me kontratë të përkohshme, sipas kërkesave të rrjetit të degeve dhe departamenteve në zyrat qendrore.

Këta punonjës marrin trajnime teorike dhe në punë (on job), për të përmbushur në mënyrë efikase kërkesat e pozicioneve përkatëse. Performuesit më të mirë inkurajohen për t'u bërë pjesë e procesit të rekrutimit për nevojat e bankës për staf të brendshëm.

Trajnimi

Raiffeisen Bank përveç përpjekjeve për të tërhequr dhe përzgjedhur punonjësit më të mirë në treg, është gjithashtu e angazhuar ndaj zhvillimit dhe rritjes së aftësive profesionale dhe njohurive të tyre. Programet e trajnimit dhe zhvillimit janë një investim strategjik për arritjen e objektivave të biznesit. Raiffeisen Bank ofron një paketë trajnimi për të gjithë punonjësit e rinj. Kjo paketë trajnimi është shumë e rëndësishme sepse u prezanton detyrat e reja që duhet të kryejnë dhe u mundëson një integrim sa më të lehtë në vendin e punës.

Stafit të bankës u ofrohen mundësi për zhvillim dhe kualifikim edhe gjatë punësimit të tyre. Banka ka ofruar një sërë programesh trajnimi dhe iniciativash të zhvillimit profesional, të cilat janë organizuar me lektorë nga burime të brendshme ose ekspertë të jashtëm. Gjatë vitit 2017, plani vjetor i trajnimit reflekton kërkesat e secilit departament për trajnime, çka synon të rrisë apo të rifreskojë njohuritë teknike ose kompetencat/aftësitë që nevojiten për të përballuar sfidat dhe përmbushur rezultatet dhe objektivat e vendosura. Në këtë kuadër, janë zhvilluar 4,792 ditë trajnimi në klasë dhe mbi 95 përqind e stafit kanë ndjekur të paktën një ditë trajnimi. Përveç trajnimit në klasë, stafit të bankës i është ofruar mundësia që të ndjekë trajnime elektronike në platformën e-learning, e cila shërben si mjet për manaxhimin e njohurive dhe informacionit. Menuja e trajnimit në këtë platformë është pasuruar gjatë vitit 2017 me module të reja, sipas kërkesave të departamenteve të ndryshme. Frekuenca e përdorimit të kësaj platforme tregon interesin e gjerë në këtë metodë mësimdhënie, e cila ofron fleksibilitet, meqenëse modulet mund të ndiqen nga posti i punës dhe në momentin kur dëshiron vetë punonjësi.

Divizioni i Burimeve Njerëzore mbështet objektivat afatgjata të biznesit duke u fokusuar në zbatimin e Politikave të Manaxhimit të Talenteve dhe Planifikimit të Zhvillimit të Pasuesve. Banka është e fokusuar në identifikimin e punonjësve të cilët shfaqin potencial të lartë për arritje dhe performancë të vazhdueshme, dhe zbaton plane për zhvillimin, ruajtjen dhe angazhimin e tyre.

Edukimi i Leadership-it dhe Manaxhimit është një tjetër fokus i Raiffeisen Bank. Programi i Trajnimit për Manaxhimin, i ofruar gjatë vitit 2017, synon të përforcojë aftësitë dhe sjelljet që manaxherët e bankës duhet të reflektojnë në mënyrë që të udhëheqin skuadrat e tyre drejt suksesit të vazhdueshëm.

Programet e rotacionit ishin një tjetër mjet zhvillimi, i ofruar për zhvillimin e stafit të Raiffeisen Bank. Këto programe u ofruan në nivel grupi dhe në nivel lokal. Objektivi i këtyre iniciativave është shkëmbimi i eksperiencave, njohurive dhe praktikave më të mira duke kryer vizita tek kolegët në departamente të tjera, brenda dhe jashtë bankës.

Politika e Shpërblimit në Raiffeisen Bank

Në Raiffeisen Bank politika e shpërblimit hartohet nga Burimet Njerëzore dhe aprovohet nga Bordi Drejtues dhe Bordi Mbikqyrës. Kjo politikë aplikohet për të gjithë punonjësit e bankës dhe filialet e bankës.

Fokusi i politikës së shpërblimit është plotësimi i standardeve ndërkombëtare me qëllim krijimin e një strukture kompesimi të drejtë dhe transparente sipas kërkesave aktuale të enteve rregullatore. Politika e shpërblimit në Raiffeisen Bank është konsistente dhe nxit frymën e manaxhimit të një risku efektiv dhe nuk inkurajon marrjen përsipër të riskut i cili tejkalon nivelin e lejuar të tij.

Kjo politikë është në të njëjtën linjë me strategjinë e biznesit, objektivat, vlerave dhe interesave afat-gjata të grupit RBI dhe të Raiffeisen Bank në Shqipëri dhe përfshin masat për të shmangur konfliktin e interesit.

Banka çdo vit identifikon funksionet/punonjësit me ndikim material në profilin e riskut të bankës. Këta punonjës përcaktohen si "Staf i Identifikuar" (Identified Staff) dhe procesi i tyre përzgjedhës bazohet në kërkesat/direktivat e grupit.

Kategoritë e "Staf i Identifikuar" janë si më poshtë:

1. Material ose "Staf i Identifikuar" me ndikim të plotë. Kjo kategori ka një ndikim material direkt në riskun e profilit të bankës, sepse niveli i riskut i cili mund të merret individualisht ose në grup, mund të ketë një ndikim thelbësor në rezultatet dhe pasqyrat financiare të bankës. Numri i punonjësve të cilët plotësojnë këto kritere është 40 dhe përfshin Bordin Mbikqyrës, Drejtorin e Përgjithshëm, Bordin Drejtues, Anëtarët e Komitetit të Auditit, Drejtuesit e Divizioneve, Drejtuesit e Departamenteve dhe Përgjegjës Sektorit.

2. Material ose "Staf i Identifikuar" me ndikim jo të plotë. Kjo kategori ka një ndikim në profilin e riskut të bankës, por jo domosdoshmërisht në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Numri i punonjësve të cilët plotësojnë këto kritere është 39 dhe përfshin Drejtuesit e Divizioneve, Drejtuesit e Departamenteve, Manaxherët Zonalë të Biznesit SE, Drejtuesit e Distrikteve dhe Përgjegjës Sektorit.

Paga dhe përfitimet e tjera mbi pagën për punonjësit përcaktohen nga banka, duke synuar nivele të kënaqshme dhe konkurruese. Politika e ndjekur nga banka në përcaktimin e sistemit dhe strukturës së pagave duhet të realizojë dhe garantojë arritjen e pesë objektivave kryesore:

- Shpërblimi për performancën dhe cilësinë e punës.
- Mbajtjen e bankës në një pozicion konkurrues në treg. Kompensimi i përgjithshëm duhet të jetë në çerekun e tretë të tregut vendas (midis 50 dhe 75 përqind), ndërsa për pozicionet drejtuese duhet të jetë në nivelin më të lartë të tregut, ndërmjet 75 përqind dhe 100 përqind.
- Motivimin e punonjësve nëpërmjet shpërblimit (pagës) të diferencuar për përgjegjësi, pozicione pune dhe aftësi profesionale të diferencuara.
- Përfitimet shtesë duhet të jenë konkurruese, por jo kryesuese në treg.
- Shpenzimet për pagat në totalin e kostos së personelit dhe buxhetit të bankës në tërësi të jenë në parametra të pranueshëm.

Për pozicionet drejtuese të nivelit të mesëm (Middle Management) dhe për stafin shitës, paga në Raiffeisen Bank është e përbërë nga dy elemente:

- Paga bazë (Paga)
- Paga variabël

Struktura e pagës bazë

- Përfaqëson të ardhurat bruto, duke përfshirë bonuset dhe përfitimet e tjera shtesë;
- Administrohet në bazë të niveleve të pagës, të cilat bazohen në strukturën e gradës, nivelin e jetesës në vend dhe të
- dhënat e tregut.

Paga Variabël (Bonusi dhe skemat nxitëse)

- Është e lidhur ngushtë me rezultatet e performancës të Grupit RBI/ Bankës/Individit.
- Ka një kufi, në mënyrë që të sigurohet një manaxhim i buxhetit brenda parametrave të arsyeshëm, pa shkelur parimin
- e shpërblimit të performancës së lartë.
- Nuk do të jetë më e lartë se:
 - 16 përqind e pagës bazë mujore/vjetore për funksionet e shitjes
 - 12 përqind e pagës bazë mujore/vjetore për funksionet mbështetëse të biznesit
- Mund të paguhet me para (Cash), në natyrë (materiale) ose në instrumenta të tjerë sipas vendimit të Bordit Mbikqyrës.

Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues

(shumat në Lekë '000)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/për periudhën aktuale Viti 2017	Për periudha të kaluara Viti 2016
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	10,695	10,856
Cash/bonus	10,695	10,856
Aksione		
Të tjera		
Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit		
Cash/bonus		
Aksione		
Të tjera		

Format dhe elementët e shpërblimit për Drejtuesit ekzekutivë

(shumat në Lekë '000)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/për periudhën aktuale Viti 2017	Për periudha të kaluara Viti 2016
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	209,669	200,790
Cash/bonus	179,227	181,961
Aksione		
Të tjera	30,442	18,829
Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit	51,836	14,421
Cash/bonus	44,420	4,072
Aksione	7,416	10,349
Të tjera		





Motivim

Grupi Raiffeisen

Pasqyrat e konsoliduara sipas Standardeve
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe
Raporti i audituesit të pavarur më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Pasqyra përmbledhëse

INFORMACION I PËRGJITHSHËM	42
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	43
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	45
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	46
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	48
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TË PARASË	49
1. Hyrje	50
2. Bazat e përgatitjes	50
3. Politikat kontabël të rëndësishme	50
4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël	60
5. Adoptimi i standardeve të reja të rishikuara dhe interpretimet	61
6. Standartet dhe interpretimet në publikim ende jo efektive	61
7. Paraja dhe ekuivalentët e saj	70
8. Shuma të kushtëzuara	70
9. Investime në letra me vlerë	71
10. Hua dhe paradhënie për klientët	73
11. Aktiv tatimor i shtyrë	84
12. Emri i mirë	84
13. Aktive jo-materiale	85
14. Ndërtesa dhe pajisje	86
15. Aktive të tjera	87
16. Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve bankare	87
17. Detyrime ndaj klientëve	88
18. Detyrime të tjera	90
19. Borxhi i varur	91
20. Kapitali	91
21. Rezerva të tjera	91
22. Interesi jo kontrollues	91
23. Të ardhura nga interesat	92
24. Shpenzime interesi	92
25. Të ardhura nga komisionet	92
26. Shpenzime komisioni	93
27. Të ardhura neto nga tregtimi	93
28. Të ardhura të tjera operative	93
29. Primi i sigurimit të depozitave	93
30. Shpenzime personeli	93
31. Shpenzime të përgjithshme administrative	94
32. Tatimi mbi fitimin	94
33. Administrimi i rrezikut financiar	95
34. Administrimi i kapitalit	104
35. Entitetet e strukturuar të pakonsoliduara	105
36. Angazhime dhe detyrime të mundshme	106
37. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare	106
38. Paraqitja e instrumentave financiarë sipas kategorisë së matjes	109
39. Palët e lidhura	110
40. Ngjarje pas datës së raportimit	111

Informacion i përgjithshëm

Drejtesit dhe Administratorët më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

Këshilli Drejtues (Këshilli Mbikëqyrës)

Peter Lennkh	Kryetar
Heinz Hodl	Anëtar
Ferenc Berszan	Anëtar
Harald Kreuzmair	Anëtar
Andreas Engels	Anëtar

Komiteti i Kontrollit

Heinz Hödl	Kryetar
Johannes Kellner	Anëtar
Susana Benoit	Anëtar

Bordi Drejtues

Christian Canacaris	Drejtor Ekzekutiv
Alexander Zsolnai	Nën kryetar i Bordit të Drejtimit
John McNaughton	Anëtar
Elona Mullahi	Anëtar
Egon Lerchster	Anëtar

Selia e regjistruar

Rruga e Kavajës, Ndërtesa 71, Apt. 4
Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 4 2381 381
Fax +355 4 2275 599

Auditues

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
Rruga Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji - Miniera, Tirana, Albania
Telefon: +355 (4) 451 7920/ 451 7954
Facsimile: +355 (4) 451 7990

Raporti i Audituesit të Pavarur

Deloitte.

Aksionarëve dhe Drejtimit të Raiffeisen Bank sh.a. dhe filialeve të saj,

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
Rr. Elbasanit,
Pallati poshte Fakulteti Gjeologji-
Miniera
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
www.deloitte.al

VAT (NUIS) No: L41709002H

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Raiffeisen Bank sh.a ("Banka") dhe filialeve të saj ("Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të konsoliduar të Grupit më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së tij financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin Vjetor, i përgatitur nga Drejtimi i Grupit në përputhje me Nenin 53 të Ligjit Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër kur të na vihen në dispozicion dhe, të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare të konsoliduara apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare të konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo anomalive. Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Grupit për të vazhduar aktivitetin e tij në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Grupit, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijjnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Grupit për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.
- Marrja e evidencave të mjaftueshme të auditimit në lidhje me informacionin financiar të entiteteve ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe performancën e auditimit të Grupit. Ne mbetemi vetëm përgjegjës për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Grupit, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.

Deloitte Audit Albania sh.p.k
Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji - Misionera,
Tiranë, Shqipëri
Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41 709002H



Enida Cara
Auditues ligjor
Partner Angazhimi

Tiranë, Shqipëri
14 qershor, 2018

Pasqyra e konsoliduar pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivët			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	7	51,071,193	57,046,334
Shuma të kushtëzuara	8	19,467,731	21,628,345
Investime të mbajtura për tregtim	9.1	7,826,094	14,198,975
Investime të mbajtura deri në maturim	9.2	72,768,827	77,833,482
Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë	9.3	2,485,514	2,528,780
Hua dhe paradhënie për klientët	10	90,081,549	90,591,932
Parapagim i tatimit mbi fitimin		1,217,819	746,741
Aktiv tatimor i shtyrë	11	20,140	28,039
Emri i mirë	12	92,783	92,783
Aktive afatgjata jomateriale	13	1,460,951	1,557,194
Ndërtesa dhe pajisje	14	1,482,584	1,603,016
Aktive të tjera	15	2,479,727	2,681,832
Totali i aktiveve		250,454,912	270,537,453
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	16	4,502,268	4,329,408
Detyrime ndaj klientëve	17	204,626,518	229,179,129
Detyrime të tjera	18	2,171,372	2,464,777
Borxh i varur	19	8,820,852	8,965,577
Totali detyrimeve		220,121,010	244,938,891
Kapitali			
Kapitali aksionar	20	14,178,593	14,178,593
Fitimi i pashpërndarë		12,849,119	8,113,779
Rezerva të tjera	21	3,306,190	3,306,190
Aktivët neto që i atribuohen aksionarëve Bankës		30,333,902	25,598,562
Interesi i pakontrollueshëm	22	-	-
Totali i kapitalit		30,333,902	25,598,562
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		250,454,912	270,537,453

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga Bordi Drejtues i Grupit Raiffeisen më 6 Qershor 2018.



Christian Canacaris
Drejtor i Përgjithshëm



Alexander Zsolnai
Nën Kryetar i Bordit Drejtues

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 50 deri në 111, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(shumat në LEK'000)

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJS DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	23	7,428,699	8,133,956
Shpenzime për interesa	24	(287,858)	(447,911)
Të ardhura neto nga interesat		7,140,841	7,686,045
Humbje neto nga zhvlerësimi i huave	10,18	447,691	(8,940,259)
Të ardhura/(Shpenzime) neto pas zhvlerësimi të huave		7,588,532	(1,254,214)
Të ardhura nga komisionet	25	3,303,163	2,852,797
Shpenzime për komisionet	26	(682,457)	(537,595)
Të ardhura neto nga komisionet		2,620,706	2,315,202
Të ardhura neto nga investimi	9.3	(36,745)	257,582
Të ardhura neto nga tregtimi	27	163,809	1,635,700
Shpenzime të tjera operative, neto	28	521,756	(351,464)
		648,820	1,541,818
Primi i sigurimit të depozitave	29	(627,567)	(665,358)
Shpenzime për personelin	30	(2,355,190)	(2,571,417)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	13,14	(639,277)	(696,369)
Shpenzime të përgjithshme administrative	31	(2,356,561)	(2,725,721)
		(5,978,595)	(6,658,865)
Fitimi/(Humbje) para tatimit		4,879,463	(4,056,059)
Tatimi mbi fitimin	32	(144,123)	(147,688)
Fitimi/(Humbje) neto për vitin		4,735,340	(4,203,747)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Zëra që mund të riklasifikohen më pas në fitim humbje:			
Investime të mbajtura për qëllime shitje:			
- Fitime minus humbje që rezultojnë gjatë vitit		-	-
- Fitime minus humbje që mund të riklasifikohen në fitim humbje pas nxjerrjes jashtë përdorimit ose zhvlerësimi		-	-
Të ardhura/(Humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse për vitin		4,735,340	(4,203,747)

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(shumat në LEK'000)

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE (VAZHDIM)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitimi/(Humbja) i atribuohet:		
- Aksionarëve të Bankës	4,735,340	(4,224,514)
- Interesi i pakontrollueshëm	-	20,767
Fitimi/(Humbja) për vitin	4,735,340	(4,203,747)
Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse i atribuohet:		
- Aksionarëve të Bankës	4,735,340	(4,203,747)
- Interesi i pakontrollueshëm	-	-
Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse për vitin	4,735,340	(4,203,747)
Fitimet/(Humbjet) për aksion nga fitimet që i atribuohen aksionarëve të Bankës, bazë dhe të pakësuar (shprehur në lekë për aksion)	676,477	(603,502)

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 50 deri në 111.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(shumat në LEK'000)

PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

	I atribuohen aksionarëve të Bankës						
	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva e rivlerësimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali	Interesi i Pakontrollueshëm	Totali i kapitalit
Teprica më 1 janar 2016	14,178,593	3,135,352	-	12,795,084	30,109,029	101,969	30,210,998
Humbja e vitit	-	-	-	(4,224,514)	(4,224,514)	20,767	(4,203,747)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	(4,224,514)	(4,224,514)	20,767	(4,203,747)
Transferimi nga fitimi i pashpërndarë në rezerva të përgjithshme	-	170,838	-	(170,838)	-	-	-
Dividend i paguar gjatë vitit	-	-	-	(266,073)	(266,073)	(15,309)	(281,382)
Shitja interesi i pakontrollueshëm	-	-	-	(19,880)	(19,880)	(107,427)	(127,307)
Teprica më 31 dhjetor 2016	14,178,593	3,306,190	-	8,113,779	25,598,562	-	25,598,562
Fitimi i vitit	-	-	-	4,735,340	4,735,340	-	4,735,340
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	4,735,340	4,735,340	-	4,735,340
Teprica më 31 dhjetor 2017	14,178,593	3,306,190	-	12,849,119	30,333,902	-	30,333,902

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet të citat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 50 deri në 111.

Pasqyra e konsoliduar e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (shumat në LEK'000)

Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi/(Humbja) para tatimit	4,879,463	(4,056,059)
- zvogëlim i rrezikut, duke përfshirë sigurim në rastet kur është efektiv.

Paftimi me standardet e Grupit mbështetet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga Kontrolli i Brendshëm. Rezultatet e kontrolleve të bëra nga Kontrolli i Brendshëm diskutohen së bashku me Manaxhimin e njësisë së biznesit me të cilën lidhen, me përmbledhjet e dorëzuara Komitetit të Kontrollit dhe Drejtimit të Lartë të Grupit.

34. ADMINISTRIMI I KAPITALIT

Objektivat e Grupit për menaxhimin e kapitalit janë (i) të jetë në përputhje me kërkesat e kapitalit të vendosura nga Banka Qendrore e Shqipërisë dhe (ii) për të ruaj aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi.

Kapitali rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit të saj duke përdorur, përveç masave të tjera, rregullat dhe raportet e vendosura nga rregullatori Shqiptar, Banka e Shqipërisë ("BSh"), e cila përfundimisht përcakton kapitalin ligjor që kërkohet për përforcimin e biznesit të saj. Rregullorja "Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit" është nxjerrë në vijim të Ligjit No. 8269 datë 23 dhjetor 1997 "Mbi Bankën e Shqipërisë" dhe "Ligji Bankar i Republikës së Shqipërisë".

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit rregullator me aktivet me rrezik dhe zërat jashtë bilancit, të shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar nga Banka e Shqipërisë për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 12%. Raporti i modifikuar i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit bazë mbi aktivet me rrezik të ponderuar dhe zërat jashtë bilancit, të shprehur në përqindje. Norma minimale e modifikuar e mjaftueshmërisë së kapitalit është 6%.

Aktivet e Ponderuara për Rrezik

Aktivet ponderohen në përputhje me kategoritë e gjera të rrezikut kombëtar, të cilave i caktohet një peshë rreziku në përputhje me sasinë e kapitalit të pashlyer që është i nevojshëm për mbështetjen e tyre. Aplikohen pesë kategori të ponderimit të rrezikut (0%, 20%, 50%, 100%, 150%); për shembull instrumentat e tregut të parasë kanë një peshë zero në rrezik që do të thotë që për mbajtjen e këtyre aktiveve nuk nevojitet kapital. Aktivet afatgjata materiale mbajnë një peshë 100% të rrezikut, që do të thotë se duhet të mbështeten nga një kapital i njëjtë me 12% të vlerës kontabël. Krediti

34. ADMINISTRIMI I KAPITALIT (VAZHDIM)

jashtë bilancit, që lidhet me angazhimet, gjithashtu merret në konsideratë. Me pas, sasi të peshohen me rrezikun duke përdorur të njëjtën përqindje si për aktivet në bilanc.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Totali i aktiveve të ponderuara me rrezik	114,853,776	132,853,009
Kapitali rregullator	23,668,639	22,570,748
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	20.61 %	16.99%

Politika e Bankës është që të mbajë një bazë të fortë kapitali të tillë që të mbajë besueshmërinë e investitorit, kreditorit dhe tregut dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Impakti i nivelit të kapitalit në kthimet për aksion njihet gjithashtu dhe Banka njih nevojën për të mbajtur një balancë ndërmjet kthimeve më të larta të mundshme nëpërmjet levave financiare dhe avantazheve të sigurisë që vijnë nga një pozicion më i qëndrueshëm dhe i favorshëm i kapitalit. Banka dhe operacionet e saj rregullative kanë qenë në përputhje me të gjitha kërkesat e kapitalit të vendosura nga jashtë gjatë të gjithë periudhës.

Kapitali rregullator i Shoqërive Administruese të fondeve të pensione ve vullnetare dhe fondeve investuese (filiali i Bankës)

Shoqëritë Administruese të fondeve të pensione ve vullnetare dhe fondeve investuese, bazuar në ligjin 10197 dhe 10198 datë 10 dhjetor 2009, në çdo kohë duhet të kenë një kapital të paktën 15,625 mijë Lek, i cili llogaritet duke zbritur detyrimet nga aktivet në pozicionin financiar të Fondit. Kur vlera neto e aktiveve në fondet e pensionit, të administruara nga shoqëria administruese, e kalon vlerën 31,250 milion Lek, shoqëria administruese duhet ta rrisë kapitalin, në mënyrë që shtesa e kapitalit të jetë të paktën e barabartë me 0,02% të vlerës me të cilën vlera neto e aktiveve të fondeve të administruara kalon pragun e përmendur. Megjithatë nuk është e nevojshme që kapitali të kalojë vlerën 1,250,000 mijë Lek. Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 Raiffeisen INVEST është në përputhje me kërkesat ligjore për kapital rregullator.

Kapitali rregullator i shoqërive të qiradhënies financiare (filiali i Bankës)

Bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për liçencimin e subjekteve jobanka" aktiviteti i qirasë financiare përfshihet në aktivitetet që kryejnë subjektet jobanka dhe përveç të tjerave, kërkesa për kapitalin minimal për fillimin e aktivitetit është 100,000 mijë Lek. Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Raiffeisen Leasing sh.a. është në përputhje me kërkesat ligjore për kapital rregullator.

Politika e Grupit është që të mbajë një bazë të fortë kapitali të tillë që të mbajë besueshmërinë e investitorit, kreditorit dhe tregut dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Impakti i nivelit të kapitalit në kthimet për aksion njihet gjithashtu, dhe Grupi njih nevojën për të mbajtur një balancë ndërmjet kthimeve më të larta të mundshme nëpërmjet levave financiare dhe avantazheve të sigurisë që vijnë nga një pozicion më i qëndrueshëm dhe i favorshëm i kapitalit. Grupi dhe operacionet e tij rregullative individuale kanë qenë në përputhje me të gjitha kërkesat e kapitalit të vendosura nga jashtë, gjatë gjithë vitit.

Nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në administrimin e kapitalit të Grupit gjatë vitit.

35. ENTITETET E STRUKTURUARA TË PAKONSOLIDUARA

Bazuar në kërkesat e SNRF 10, ekspozimi ndaj kthimeve të ndryshueshme duhet të jetë shumë më lart se ekspozimi nga tarifat e menaxhimit të nivelit të tregut të aktiveve, në mënyrë që të merret në konsideratë konsolidim i fondeve që menaxhohen nga subjekti, në pasqyrat financiare. Ky nuk është rasti për Grupin, i cili ka të drejtë të 1,5% të vlerës neto të aktiveve të fondeve të investimit. Më tej, Grupi nuk ka në pronësi ndonjë njësi të investimeve në fondin e pensione ve apo në fondet e investimeve. Aktivet e Fondit menaxhohen në formë unzae nga Shoqëria Administruese (filial i grupit). Sipas legjislacionit Shqiptar për fondet e pensione ve dhe fondet e investimeve, titulli ligjor mbi aktivet e Fondit mbetet me kontribuesit. Si pasojë, Grupi nuk ka konsoliduar ndonjë prej fondeve të administruara nga një prej filialeve të tij në pasqyrat financiare të konsoliduara 2017. Informacioni në lidhje me subjektet e pakonsoliduara të strukturuar është si vijon:

35. ENTITETET E STRUKTURUARA TË PAKONSOLIDUARA (VAZHDIM)

	Per vitin e mbyllur deri më 31 dhjetor 2017	31 Dhjetor 2017		
	Të ardhura për vitin	Vlera e mbartur e aktiveve të njohura për ekspozim ndaj entitetit	Vlera e mbartur e detyrimeve të njohura për ekspozim ndaj entitetit	Ekspozimi maksimal ndaj humbjes nga interesi të entitetit
<i>Në mijë lekë</i>				
Fondi Prestigj	2,136,313	57,259,184	170,943	57,088,241
Fondi i pensionit	25,874	509,190	2,215	506,975
Fondi Euro	229,298	14,745,379	31,937	14,713,442
TOTAL	2,391,485	72,513,753	205,095	72,308,658

36. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME

			31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
	LEK	Monedhë e huaj	Totali	Totali
<i>Detyrime të mundshme</i>				
Garanci bankare të lëshuara	1,614,960	6,533,217	8,148,177	8,043,303
Letër kredi	-	1,576,604	1,576,604	1,906,145
Linja të papërdorura krediti	4,148,703	7,351,098	11,499,801	11,072,480
Totali	5,763,663	15,460,919	21,224,582	21,021,928

Pjesa më e madhe e garancive bankare dhe letër kredive të mësipërme janë për periudha kohore më pak se një vit dhe kanë si kolateral depozitat e bllokuara të klientëve.

Angazhimet për qiratë e zakonshme operative

Grupi ka hyrë në angazhime të pakthyeshme qiraje të zakonshme operative për Drejtorinë e Përgjithshme dhe degët. Angazhime të tilla më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<i>Jo më vonë se 1 vit</i>	205,282	336,286
<i>Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vjet</i>	622,532	769,681
Totali	827,814	1,105,967

37. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE

Matjet e vlerës së drejtë analizohen nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë: (i) niveli parë janë një matje me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për aktive ose detyrime të njëjta, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknika të vlerësimit me të gjitha inputet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose pasivin në mënyrë të drejtpërdrejtë (që është , si çmimet) ose indirekt (domethënë , rrjedhin nga çmimet), dhe (iii) të nivelit të tre matjet janë vlerësimet jo të

37. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE (VAZHDIM)

bazuara në të dhëna të vëzhgueshme në treg (pra, jo të inpueteve vëzhgueshme). Drejtimi aplikon gjykimin në kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse matja e një vlere të drejtë përdor të dhëna të vëzhgueshme që kërkojnë rregullim të rëndësishëm, ajo matje është matje e Nivelit 3. Rëndësia e një inputi vlerësimi vlerësohet kundrejt matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e tij. Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ata që standarde të kontabilitetit kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese. Vlerat e drejta të analizuar nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlerat kontabël të aktiveve jo të matura me vlerën e drejtë janë si më poshtë:

2017				
	Vlera e drejtë Nivel 1	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3	Totali
Hua dhe paradhënie me bankat	-	28,699,610	7,922,807	36,622,417
Hua dhe paradhënie për klientët	-	-	90,081,549	90,081,549
Letrat me vlerë të tregëtueshme	-	7,826,094	-	7,826,094
Investime të mbajtura në maturim	-	73,085,558	-	73,085,558
Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	2,485,514	-	2,485,514
Detyrime nga bankat	-	6,167	4,496,101	4,502,268
Depozita nga klientet	-	-	204,610,355	204,610,355
Borxhi i varur	-	8,820,852	-	8,820,852
Garanci dhe angazhime	-	2,676,015	18,548,567	21,224,582
2016				
	Vlera e drejtë Nivel 1	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3	Totali
Hua dhe paradhënie me bankat	-	15,298,756	18,195,896	33,494,652
Hua dhe paradhënie për klientët	-	-	90,591,932	90,591,932
Letrat me vlerë të tregëtueshme	-	14,198,975	-	14,198,975
Investime të mbajtura në maturim	-	78,111,054	-	78,111,054
Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	2,528,780	-	2,528,780
Detyrime nga bankat	-	22,616	4,306,792	4,329,408
Depozita nga klientet	-	-	229,165,584	229,165,584
Borxhi i varur	-	8,965,577	-	8,965,577
Garanci dhe angazhime	-	131,824	20,890,104	21,021,928

Paraaja dhe ekuivalentët e saj

Paraaja dhe ekuivalentët e saj përfshijn depozita ndërmjet bankave dhe mjete të tjera në procesin e arkëtimit. Duke qënë se këto balanca kanë afat të shkurtër dhe janë me norma interesi të ndryshueshme, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën kontabël.

Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të aktualizuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur. Instrumentat e mbajtur deri në maturim klasifikohen në nivelin 2 sepse tregu për këta instrumente është më pak aktiv.

Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhënie mbarten me vlerën e mbetur pakësuar nga provigjonet. Portofoli i huave të Grupit ka një vlerë të drejtë të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të afatit të shkurtër ose normave të interesit të afërta me normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolit të huave është subjekt i rçmimeve brenda një viti.

37. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE (VAZHDIM)

Detyrime nga/ ndaj bankave dhe institucioneve financiare

Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve ndaj bankave dhe institucioneve financiare është pothuajse e barabartë me vlerën e tyre të mbartur për shkak të afatit të shkurtër ose normave të interesit të përafërta me normat e tregut

Depozita nga klientët

Vlera e drejtë e depozitave pa afat, që përfshin dhe depozitat pa interes, është vlera që i paguhet klientit sipas kërkesës.

Borxhi i varur

Vlera e drejtë e borxhit të varur ka një vlerë të drejtë që i afrohet vlerës së tij kontabël për shkak të normës së tij të interesit që i përafrohet normave të tregut.

Garancitë dhe angazhimet

Vlera e drejtë e garancive dhe angazhimeve, kryesisht përbëhen nga primet e paamortizuara dhe të pranuarra për lëshimin e garancive.

Sensitiviteti i vlerës së drejtë

Përshkrimi i teknikës së vlerësimit dhe përshkrimi i inputeve të përdorura në matjen e vlerës së drejtë për të nivelit 2 matjet në 31 dhjetor 2017 ishte si më poshtë:

Në mijë LEK	Vlera e drejtë	Teknika e vlerësimit	Inputet e përdorura
Aktivitet financiar me vlerën e drejtë			
Letra me vlerë të tregtueshme			
Bono thesari shqiptare	918	Flukset e parasë e aktualizuar (FPA)	Kurba e bonove qeveritare
Obligacione qeveritare	7,825,176	FPA	Kurba e bonodeve qeveritare
Të tjera letra me vlerë të vlerësuar nëpërmjet fitimit ose humbjes			
Obligacione qeveritare	2,485,514	FPA	Kurba e bonodeve qeveritare

Përshkrimi i teknikës së vlerësimit dhe përshkrimi i inputeve të përdorura në matjen e vlerës së drejtë për të nivelit 2 matjet në 31 dhjetor 2016 ishte si më poshtë:

Në mijë LEK	Vlera e drejtë	Teknika e vlerësimit	Inputet e përdorura
Aktivitet financiar me vlerën e drejtë			
Letra me vlerë të tregtueshme			
Bono thesari shqiptare	89,718	Flukset e parasë e aktualizuar (RPS)	Kurba e bonove qeveritare
Obligacione qeveritare	14,106,796	FPA	Kurba e bonodeve qeveritare
Të tjera letra me vlerë të vlerësuar nëpërmjet fitimit ose humbjes			
Obligacione qeveritare	2,528,780	FPA	Kurba e bonodeve qeveritare

38. PARAQITJA E INSTRUMENTAVE FINANCIARË SIPAS KATEGORISË SË MATJES

Për qëllime matjeje, SNK 39 "Instrumentat financiarë: Njohja dhe Matja", i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: (a) hua dhe paradhënie; (b) aktive financiare të mbajtura për shitje; (c) aktive financiare të mbajtura në maturim dhe (d) aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarive të fitim humbjes ("FVTPL"). Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarive të fitim humbjes ndahen në dy kategori: (i) aktive të destinuar si të tilla që në njohje dhe (ii) ato të klasifikuara të mbajtura për tregtim. Qeraja financiare është një kategori më vete. Tabela e mëposhtme paraqet aktivet financiare sipas këtyre kategorive të matjes në 31 dhjetor 2017:

	Hua dhe paradhënie	Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimi ose humbjes	Investime të mbajtura për tregtim	Investime të mbajtura në maturim	Totali
Aktivët					
Paraqja dhe ekuivalentët e saj	51,071,193	-	-	-	51,071,193
Shuma të kushtëzuara	19,467,731	-	-	-	19,467,731
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	7,826,094	-	7,826,094
Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes	-	2,485,514	-	-	2,485,514
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	72,768,827	72,768,827
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	90,081,549	-	-	-	90,081,549
Total Aktive financiare	160,620,473	2,485,514	7,826,094	72,768,827	243,700,908

Tabela e mëposhtme paraqet aktivet financiare sipas këtyre kategorive të matjes në 31 dhjetor 2016:

	Hua dhe paradhënie	Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimi ose humbjes	Investime të mbajtura për tregtim	Investime të mbajtura në maturim	Totali
Aktivët					
Paraqja dhe ekuivalentët e saj	57,046,334	-	-	-	57,046,334
Shuma të kushtëzuara	21,628,345	-	-	-	21,628,345
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	14,198,975	-	14,198,975
Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes	-	2,528,780	-	-	2,528,780
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	77,833,482	77,833,482
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	90,591,932	-	-	-	90,591,932
Total Aktive financiare	169,266,611	2,528,780	14,198,975	77,833,482	263,827,848

Në 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, të gjitha detyrimet financiare të Grupit përveç derivativeve mbahen me vlerë të mbetur.

39. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen në përgjithësi të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontroll të përbashkët, ose njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale. Kur konsiderohet çdo marrëdhënie ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

Banka ka marrëdhënie me palë të lidhura me Raiffeisen International AG, Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft, me filialet dhe filialeve e tze Raiffeisen Leasing sh.a. dhe Raiffeisen Invest sh.a., dhe me drejtorët e tij dhe zyrtarët ekzekutiv.

Grupi i jep hua për të dhe ka marrë depozita nga subjektet e tjera të ngjashme. Kreditë dhe depozitat e tilla janë individualisht të parëndësishme dhe janë futur në përgjithësi në kushte të lira tregu.

Vlera totale e transaksioneve dhe bilanceve të papaguara lidhen me këto palët e lidhura ishin si vijon:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kërkesa nga		
Shoqëria mëmë e drejtpërdrejtë	6,561,087	6,756,474
Të tjera shoqëri të lidhura	11,468,932	13,698,919
Totali i aktiveve	18,030,019	20,455,393
Detyrimet ndaj		
Shoqëria mëmë e drejtpërdrejtë	(8,884,123)	(9,059,028)
Të tjera shoqëri të lidhura	(26)	-
Totali i detyrimeve	(8,884,149)	(9,059,028)
	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhurat nga interesi, neto		
Shoqëria mëmë e drejtpërdrejtë	(456,859)	(531,564)
Të tjera shoqëri të lidhura	42,499	10,930
Totali të ardhurat nga interesi, neto	(414,360)	(520,634)
Shpenzime komisioni, neto		
Shoqëria mëmë e drejtpërdrejtë	(40,101)	(52,718)
Të tjera shoqëri të lidhura	(117,650)	(128,520)
Totali shpenzime komisioni, neto	(157,751)	(181,238)
Shpenzime administrative		
Shoqëria mëmë e drejtpërdrejtë	(428,725)	(469,300)
Të tjera shoqëri të lidhura	(307)	(3,349)
Totali shpenzime administrative	(429,032)	(472,649)
Totali	(1,001,143)	(1,174,521)

Të përfshira në shumat e detyrueshme ndaj prindit të drejtpërdrejtë është borxhi i varur, i cili është detajuar në shënimin 19.

Vlera agregate e detyrimeve të mundshme të Grupit ndaj shoqërive të lidhura është 2,676,015 mijë Lek më 31 dhjetor 2017 (31 dhjetor 2016: 2,003,508 mijë Lek) dhe përfaqëson garanci bankare, letra të kredisë dhe angazhime të lëshuara.

39. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Personeli kyç i manaxhimit

Vlera totale e transaksioneve dhe bilanceve të papaguara që lidhen me personelin drejtues kryesor ishin si më poshtë:

	2017	2016
Pasqyra e pozicionit financiar		
Detyrimet nga	156,079	158,415
Detyrimet ndaj	(117,010)	(112,043)
Tepricat neto	39,069	46,372
Shpenzime		
Pagat dhe shpërblimet	(271,325)	(262,512)
Totali	(271,325)	(262,512)

40. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat kërkojnë rregullim apo paraqitje në pasqyrat financiare të konsoliduara.

The background features a large, abstract geometric composition. A prominent red shape, resembling a stylized letter 'E' or a series of connected triangles, is set against a white background. The red shape has a curved top edge and several sharp, angular protrusions and indentations. A horizontal grey bar is positioned across the upper part of the red shape, containing the word 'Vizion' in white text.

Vizion



Raiffeisen Leasing në Shqipëri

Raiffeisen Leasing Sh.a është kompani shqiptare, regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë numër 35733, date 15.05.2006. Kompania filloi aktivitetin në maj 2006.

Aktiviteti kryesor i kompanisë është Qiraja Financiare për bizneset dhe individët.

Raiffeisen Leasing sh.a. është krijuar me qëllim shtimin dhe promovimin e veprimtarisë së qirasë financiare në Shqipëri, dhe në të njëjtën kohë rritjen e gamës së shërbimeve të ofruara nga grupi i bankës Raiffeisen në këtë treg.

Kapitali i nënshkruar aksioner është i regjistruar në Lekë. Duke filluar nga 10 tetori, 2016, Banka Raiffeisen Sh.a. është aksioneri i vetëm i Raiffeisen Leasing Sh.a.

Gjatë vitit 2017, Raiffeisen Leasing Albania ja doli mbanë të forcojë më tej pozitat e tij si numri një në tregun shqiptar të financimit nëpërmjet qirasë financiare.

Vlera e financuar për vitin 2017, ka arritur shifrat 12 milionë Euro, një rritje me më shumë se 24 përqind në krahasim me vitin e kaluar, ku 10,8 milionë Euro janë për mjete të lëvizshme dhe 1,2 milionë Euro për pajisje.

Produktet kryesore të Raiffeisen Leasing janë financimi i mjeteve të lëvizshme dhe pajisjeve

Të gjithë produktet e lizingut u janë ofruar segmenteve të biznesit si korporatat dhe bizneset e mesme, ndërkohë që individët e përdorin kryesisht për makina personale.

48 përqind e kontratave të reja të qirasë financiare janë bërë me klientët korporatë, 14 përqind me biznesin e mesëm, 17 përqind me biznesin e vogël dhe pjesa tjetër, 22 përqind me klientët individë.

Qëllimi ynë ka qenë kryesisht në forcimin e bashkëpunimit afatgjatë me klientët e Grupit Raiffeisen, duke ofruar mbështetje të frytshme për nevojat e tyre në biznes. Gjithashtu, për të qenë më pranë, Raiffeisen Leasing i ka kushtuar kujdes të veçantë forcimit dhe vendosjes së bashkëpunimit strategjik me rrjetin e koncensionarëve të shitjeve të makinave që operojnë në Shqipëri.

Viti 2017 ishte sërish një vit sfidues përse i përket tregut të mjeteve të lëvizshme, ku numri i mjeteve të shitura kaloi lehtësisht sasinë prej 3,200 njësi, shifër e cila zë rreth 6 përqind të numrit total të makinave të shitura në Shqipëri. Raiffeisen Leasing, i ofron klientëve të tij produkte dhe shërbime me cilësi superiore, si dhe informacion të plotë lidhur me strukturën dhe thjeshtësinë e të gjitha veprimeve të qirasë financiare.

Pjesë e aktivitetit tonë është edhe rimarketimi e rishitja e mjeteve. Përse i përket rishitjes kemi implementuar procedurë që na kanë pozicionuar si ekspert për vendosjen e standardeve në treg. Gjithsesi kompania ka përdorur njohuritë dhe eksperiencën e Raiffeisen Leasing International si dhe të kompanive të tjera të lizingut që veprojnë në rajon lidhur me produktet dhe shërbimet e qirasë financiare, si dhe në fushën e marketingut. Për më tepër, kompania ka marrëdhënie me rrjetin e madh të furnitorëve ndërkombëtarë të makinave me tonazh të rëndë, makinerive dhe paisjeve, me të cilët Grupi Raiffeisen ka lidhje të qëndrueshme, në dobi të klientëve ekzistues dhe potencialë të kompanisë për realizimin e planeve të tyre investuese.

Deri në fund të vitit 2017, Raiffeisen Leasing kishte 19 punonjës, që ju ofrojnë klientëve shërbime të shpejta dhe të përshtatshme për nevojat e tyre.

Raiffeisen Leasing publikon një gamë të gjerë materialesh si të printuar ashtu edhe në faqen e internetit www.raiffeisen-leasing.al. Gjatë vitit 2017 Raiffeisen Leasing Sh.a ka ndërmarrë fushatë marketingu, kryesisht të bazuar dhe të koordinuar me politikat dhe aktivitetet e marketingut të konçesionarëve vendas si partnerët tanë kryesorë në biznes. Manaxhimi dëshiron të përfitojë nga kjo mundësi për të falenderuar klientët dhe partnerët e biznesit për bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë 2017 dhe sidomos për besimin që ata na kanë dhënë. Gjithashtu jemi shumë mirënjohës ndaj punonjësve tanë për përkushtimin dhe përpjekjet, duke shprehur bindjen tonë që ekipi i Raiffeisen Leasing do të vazhdojë përpjekjet për të qëndruar lider të tregut edhe për vitin 2018.

Perspektivat për vitin 2018

Në sajë të standardeve të larta profesionale dhe ekspertizës së grupit, që janë shumë të forta edhe në kohë të vështirë, Raiffeisen Leasing sh.a do të jetë në pozita që të mbështesë në mënyrë aktive bizneset në planet e tyre të investimeve edhe gjatë 2018, duke ofruar financimin e mjeteve të lëvizshme dhe pajisjeve. Ne do të jemi tërësisht të përkushtuar në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit afatgjatë me klientët dhe koncesionarët tanë dhe do të vazhdojmë në mënyrë aktive t'ju përgjigjemi nevojave të tyre me gamën e produkteve dhe shërbimeve tona.

Duke patur parasysh ndryshimet e mjedisit të biznesit, objektivat tona kryesore do të jenë rritja e biznesit, përmirësimi i shitjeve të kryqëzuara me të gjithë segmentet e bankës, përmirësimin e vazhdueshëm të produkteve ekzistuese dhe zhvillimin e të reja, manaxhimin e rrishtatshëm, reduktimi i kostove dhe përmirësimin e efikasitetit. Ne jemi tërësisht të përkushtuar për të ruajtur qëndrueshmërinë e portofolit aktual duke aplikuar principin e cilësisë, në vend të madhësisë dhe politikë të fortë të riskit.

Ekspertiza jonë dhe mbështetja e grupit Raiffeisen, baza e fortë e kapitalit dhe cilësia e portofolit përfaqësojnë garanci që ne do të mbetemi një partner i sigurt dhe i përgjegjshëm për klientët dhe koncesionarët në periudhën në vazhdim.



Synime



Raiffeisen INVEST Sh.a

Rreth Raiffeisen INVEST Sh.a

Gjatë vitit 2017, Raiffeisen INVEST Sh.a vazhdoi të ishte lider i manaxhimit të asetëve në tregun financiar shqiptar, me një fokus të qartë në kujdesin ndaj investitorëve dhe zbatimin e praktikave më të mira të manaxhimit të asetëve. Objektivi strategjik i Raiffeisen INVEST është promovimi i fondeve për masën e gjerë të investitorëve me objektivin e një rritjeje të qendrueshme të asetëve dhe zhvillimin e tregut vendas të fondeve të investimit dhe fondeve të pensionit vullnetar.

Raiffeisen INVEST synon të ofrojë nivelin më të lartë të transparencës ndaj investitorëve dhe edukimin e publikut mbi tregjet e kapitalit në Shqipëri.

Edhe gjatë vitit 2017, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare liçencoi një shoqëri të tretë administruese për fondet e investimit, duke rritur konkurrencën në tregun e fondit të investimeve, një tjetër hap pozitiv drejt konsolidimit të mëtejshëm të këtij tregu.

Asetet nën administrim të Raiffeisen INVEST njohën një ulje të lehtë krahasuar me vitin paraardhës por gjithsesi tejkaluan vlerën prej 544 milionë Euro, ndërsa numri i atyre që i besuan shoqërisë manaxhimin e asetëve të tyre, ishte 30,900 investitorë për fondet e investimit dhe 2,800 investitorë për fondin e pensionit vullnetar. Të dyja fondet e investimit njohën një rritje prej 10 përqind të asetëve krahasuar me vitin e mëparshëm. Në një mjedis financiar me norma të ulëta interesi, investitorët vendas vazhduan të tregojnë interes për fondet e investimit, të cilat i ofrojnë publikut mundësi për të investuar kursimet e tyre në Lekë dhe në Euro në mënyrë fitimprurëse, dhe njëkohësisht mundësi për diversifikim të portofolit financiar jashtë spektrit të produkteve bankare. Gjithashtu fondet e investimit janë një alternativë investimi që kryhet përmes një procesi të thjeshtë për këdo dhe ofrojnë likuiditet në çdo kohë si dhe një manaxhim profesional financiar.

Asetet e Fondit të Pensionit Vullnetar u rritën me 23 përqind dhe shoqëria shtoi përpjekjet për të promovuar fondin e pensionit në formën e planeve individuale dhe profesionale të pensionit.

Performanca e Fondeve

Gjatë vitit 2017, fondet nën administrim të Raiffeisen INVEST gjeneruan një kthim neto nga investimi (pas zbritjes së tarifës së administrimit) si më poshtë:

- Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen: 5.86 përqind,
- Fondi i investimit Raiffeisen Prestigj: 3.87 përqind
- Fondi i investimit Raiffeisen Invest Euro: 2.72 përqind

Megjithëse gjatë vitit 2017 ka dominuar një mjedis financiar me norma shumë të ulëta interesi si në tregun vendas ashtu dhe në atë ndërkombëtar, Raiffeisen Invest arriti të sigurojë performancë të lartë për të gjithë fondet nën administrim. Si për fondet e investimit, ashtu edhe për fondin e pensionit vullnetar është zbatuar një politikë investimi e kujdesshme duke ndërthurur një manaxhim efikas të rreziqeve me shpërndarjen efektive të asetëve, me synim kthimin sa më të kënaqshëm për investitorët e fondeve. Portofolet e investimeve janë përshtatur në përputhje me këtë objektiv, si dhe në përputhje me zhvillimet e tregut, bazuar në një përzgjedhje të kujdesshme të instrumenteve financiare. Në varësi të fondit, asetet janë investuar në instrumente të ndryshme financiare në Lekë dhe në Euro, në tregun shqiptar dhe/ose tregjet ndërkombëtare.

Përgjegjësia sociale

Përveçse një viti të suksesshëm për sa i përket rritjes së asetëve nën administrim dhe numrit të investitorëve, Raiffeisen INVEST në bashkëpunim të ngushtë me Raiffeisen Bank dha një kontribut të rëndësishëm për shoqërinë dhe ekonominë shqiptare nëpërmjet programit të saj të sponsorizimeve. Ky program konsistoi në dhurime të konsiderueshme për shoqata bamirësie, institucione të ndryshme jo-fitimprurëse si dhe projekte që kanë për qëllim përmirësimin e jetës ekonomikosociale të qytetarëve shqiptarë.

Pritshmëritë për vitin 2018


Viti 2018 pritet të jetë përsëri vit sfide për ekonominë shqiptare dhe tregun financiar në tërësi. Megjithë rritjen e lehtë të normave të interesit, ato mbeten në nivele të ulëta historike. Këto të fundit si edhe niveli i lartë i likuiditetit në tregun vendas do të vazhdojnë të ndikojnë në uljen e kostove të financimit si dhe shërbimit të borxhit, duke përmirësuar shëndetin financiar të ekonomisë, duke ndikuar në rritjen e kreditimit dhe aktivitetit ekonomik në përgjithësi, pavarësisht se këto mund të jenë të kushëtzuar nga zhvillimet politike në vend.

Ekonomia e Eurozonës gjithashtu pritet të ketë ecuri pozitive dhe përfundimisht të dalë nga ambjenti deflacionist i viteve të fundit. Megjithatë ekonomia do të vazhdojë të ndikohet nga pasojat e Brexit-it dhe zgjedhjet politike në shumë vende të BE-së.

Raiffeisen INVEST do të vazhdojë të ketë në fokus rritjen e asetëve nën administrim, diversifikimin e portofolit të produkteve të ofruara me objektiv përfundimtar përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë dhe të investitorëve të saj. Shërbimi cilësor për investitorët, edukimi i vazhdueshëm i publikut mbi tregjet financiare dhe gjenerimi i një performancë të kënaqshme të fondeve aktuale do të jenë prioritetet kryesore të biznesit tonë. Raiffeisen INVEST do të shtojë përpjekjet dhe iniciativat e veta për të kontribuar në zhvillimin e tregut të kapitalit në Shqipëri si dhe zgjerimin e tregut të pensioneve private, tashmë i mbështetur nga lehtësirat e duhura fiskale.



Zhvillim



Një vështrim mbi Raiffeisen Bank International

Raiffeisen Bank International AG, përfshin Austrinë ku është kompani dhe bankë investimi lider, si edhe Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL) si tregun e saj mëmë. Fillialet bankare mbulojnë 14 tregje në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore. Ndër të tjera grupi përfshin edhe shërbime të tjera financiare aktive në fusha si leasing (qira financiare), manaxhimi i aseteve dhe M&A.

Rreth 50,000 punonjës i shërbejnë 16.5 milionë klientëve në më shumë se 2,400 pika biznesi, kryesisht në EQL. Aksionet e RBI AG janë listuar në bursën e Vienës që në vitin 2005.

Në fund të vitit 2017 asetet totale të RBI-së ishin 135 miliardë Euro. Bankat Raiffeisen në rajon përbëjnë rreth 58.8 përqind të aksioneve të RBI-së dhe rreth 41.2 përqind e mbetur e aksioneve janë të lira

Në vazhdim të bashkimit në mars 2017 me Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB AG), aksioneri i saj më i madh, RBI AG mori të gjitha të drejtat, detyrimet dhe transferimin e kompanisë RZB AG në tërësinë e saj, në veçanti, rolin e institucionit qendror të Grupit Bankar Austriak Raiffeisen.

Rrjeti i Raiffeisen Bank SHA

Distrikti Tirana 1

Rruga e Kavajës,
Pallati 71, Shkalla 1, Ap 4, Tiranë

Tel: +355 4 2253 644/6;
+355 4 2233 396

+355 4 2224 540

Fax: +355 4 2230 013

+355 4 2247 912

Tel: +355 22 43171

+355 22 43764

Lagja Nr. 5 ,Rruga "Islam Spahiu", Kukës

Tel: +355 24 22279

Distrikti Elbasan

Lagja "Qemal Stafa", Rruga "11 Nëntori",
Pallati i ri, Elbasan

Tel: +355 54 42260

Distrikti Tirana 2

Rruga "Vangjel Noti",
Nd: 12, H 6, Laprakë, Tiranë

Tel: +355 4 2357828

Distrikti Jug-Lindor

Shëtitore "Fan S. Noli", Silver Center, Korçë

Tel: +355 82 43179

Fax: +355 82 45870

Distrikti Perëndimor

Lagja 3, Rruga "Hamdi Troplini",
Pallati 12-katësh, pranë Bashkisë, Durrës.

Tel: +355 52 254 95

+355 52 25 027

Lagja "28 Nëntori", Berat

Tel: +355 32 32628

Lagja "Pavarësia", Blvd "Ismail Qemali",
përballë "Kullave Aleksandria", Vlorë

Tel: +355 33 227 381

Distrikti Verior

Hotel Rozafa, Lagja "Vasil Shanto",
Rruga Teuta, Shkodër

Për më tepër informacion ju lutem vizitoni faqen tonë të internetit: www.raiffeisen.al

Adresat dhe Kontakte

Raiffeisen Bank International AG

Austri

Am Stadtpark 9
1030 Vienna
Tel: +43-1-71 707-0
Fax: +43-1-71 707-1715
SËIFT/ BIC: RZBATËË
www.rbinternational.com
ir@rbinternational.com
communications@rbinternational.com

Rrjeti i Bankave

Shqipëri

Raiffeisen Bank Sh.A.
"European Trade Center"
Bulevardi "Bajram Curri"
Tirana
Tel: +355-4-23 8 100
Fax: +355-4-22 755 99
SËIFT/BIC: SGSBALTX
www.raiffeisen.al

Bjellorusi

Priorbank JSC
V. Khoruzhey str. 31-A
220002 Minsk
Tel: +375-17-28 9-9090
Fax: +375-17-28 9-9191
SËIFT/BIC: PJCBY2X
www.priorbank.by

Bosnje dhe Hercegovinë

Raiffeisen Bank d.d.
Bosna i Hercegovina
Zmaja od Bosne bb
71000 Sarajevo
Tel: +387-33-287 100
Fax: +387-33-21 385 1
SËIFT/BIC: RZBABA2S
www.raiffeisenbank.ba

Bullgari

Raiffeisenbank (Bulgaria) EAD
Nikola I. Vapzarov Blvd.
Business Center EXPO 200 PHAZE
III, floor 5
1407 Sofia
Tel: +359-2-91 985 101

Fax: +359-2-94 345 28
SËIFT/BIC: RZBBBGSF
www.rbb.bg

Kroaci

Raiffeisenbank Austria d.d.
Magazinska cesta 69
10000 Zagreb
Tel: +385-1-45 664 66
Fax: +385-1-48 116 24
SËIFT/BIC: RZBHHR2X
www.rba.hr

Republika Çeke

Raiffeisenbank a.s.
Hvezdova 1716/2b
14078 Prague 4
Tel: + 420-412 446 400
Fax: +420-234-402-111
SËIFT/BIC: RZBCCZPP
www.rb.cz

Hungari

Raiffeisen Bank Zrt.
Akadémia utca 6
1054 Budapest
Tel: +36-1-48 444-00
Fax: +36-1-48 444-44
SËIFT/BIC: UBRTHUHB
www.raiffeisen.hu

Kosovë

Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.
Rruga UÇK, No. 51
10000 Pristina
Tel: +381-38-22 222 2
Fax: +381-38-20 301 130
SËIFT/BIC: RBKOKKPR
www.raiffeisen-kosovo.com

Poloni

Raiffeisen Bank Polska S.A.
Ul. Grzyboëska 78
00-844 Èarsaë
Tel: +48-22-347 7000
Fax: +48-22-347 7001
SËIFT/BIC: RCBËPLPË
www.raiffeisen.pl

Rumani

Raiffeisen Bank S.A.
Calea Floreasca 246C
014476 Bucharest
Tel: +40-21-30 610 00

Fax: +40-21-23 007 00
SËIFT/BIC: RZBRROBU
www.raiffeisen.ro

Rusi

AO Raiffeisenbank
Smolenskaya-Sennaya 28
119002 Moscoë
Tel: +7-495-72 1-9900
Fax: +7-495-72 1-9901
SËIFT/BIC: RZBMRUMM
www.raiffeisen.ru

Serbi

Raiffeisen banka a.d.
Djordja Stanojevic 16
11070 Novi Beograd
Tel: +381-11-32 021 00
Fax: +381-11-22 070 80
SËIFT/BIC: RZBSRSBG
www.raiffeisenbank.rs

Slovaki

Tatra banka, a.s.
Hodzovo námestie 3
P.O. Box 42
85005 Bratislava 55
Tel: +421-2-59 19-1000
Fax: +421-2-59 19-1110
SËIFT/BIC: TATRSKBX
www.tatrabanka.sk

Ukrainë

Raiffeisen Bank Aval JSC
9, vul Leskova
01011 Kiev
Tel: +38-044-49 088 88
Fax: +38-044-295-32 31
SËIFT/BIC: AVALUAUK
www.aval.ua

Kompani Lizingu

Austri

Raiffeisen-Leasing
International GmbH
Am Stadtpark 3
1030 Vienna
Tel: +43-1-71 707-2071
Fax: +43-1-71 707-76 2966
www.rli.co.at

Shqipëri

Raiffeisen Leasing Sh.a.
 "European Trade Center"
 Bulevardi "Bajram Curri"
 Tirana
 Tel: +355-4-22 749 20
 Fax: +355-4-22 325 24
 www.raiffeisen-leasing.al

Bjellorusi

"Raiffeisen-Leasing" JLLC
 V. Khoruzhey 31-A
 220002 Minsk
 Tel: +375-17-28 9-9394
 Fax: +375-17-28 9-9974
 www.rl.by

Bosnje dhe Hercegovinë

Raiffeisen Leasing d.o.o. Sarajevo
 Zmaja od Bosne bb.
 71000 Sarajevo
 Tel: +387-33-254 354
 Fax: +387-33-212 273
 www.rlbh.ba

Bullgari

Raiffeisen Leasing Bulgaria OOD
 32A Cherni Vrah Blvd. Fl.6
 1407 Sofia
 Tel: +359-2-49 191 91
 Fax: +359-2-97 420 57
 www.rlbgbg

Kroaci

Raiffeisen Leasing d.o.o.
 Radnicka cesta 43
 10000 Zagreb
 Tel: +385-1-65 9-5000
 Fax: +385-1-65 9-5050
 www.rl-hr.hr

Republika Çeke

Raiffeisen-Leasing s.r.o.
 Hvezdova 1716/2b
 14078 Prague 4
 Tel: +420-2-215 116 11
 Fax: +420-2-215 116 66
 www.rl.cz

Hungari

Raiffeisen Corporate Lizing Zrt.
 Akademia ut. 6
 Tel: +36-1-477 8709
 Fax: +36-1-477 8702
 www.raiffeisenlizing.hu

Kazakistan

Raiffeisen Leasing Kazakhstan LLP
 Shevchenko Str. 146, flat 1
 050008 Almaty
 Tel: +7-727-378 54 30
 Fax: +7-727-378 54 31
 www.rlkz.at

Kosovë

Raiffeisen Leasing Kosovo
 Gazmend Zajmi n.n., Sunny Hill
 10000 Pristina
 Tel: +381-38-22 222 2
 Fax: +381-38-20 301 103
 www.raiffeisenleasing-kosovo.com

Moldavi

I.C.S. Raiffeisen Leasing S.R.L.
 Alexandru cel Bun 51
 2012 Chisinau
 Tel: +373-22-27 931 3
 Fax: +373-22-22 838 1
 www.raiffeisen-leasing.md

Rumani

Raiffeisen Leasing IFN S.A.
 Calea Floreasca 246 D
 014476 Bucharest
 Tel: +40-21-36 532 96
 Fax: +40-37-28 799 88
 www.raiffeisen-leasing.ro

Rusi

ООО Raiffeisen-Leasing
 Smolenskaya-Sennaya 28
 119121 Moscoë
 Tel: +7-495-72 1-9980
 Fax: +7-495-72 1-9901
 www.raiffeisen-leasing.ru

Serbi

Raiffeisen Leasing d.o.o.
 Djordja Stanojevic 16
 11070 Novi Beograd
 Tel: +381-11-220 7400
 Fax: +381-11-228 9007
 www.raiffeisen-leasing.rs

Slovakia

Tatra-Leasing s.r.o.
 Cernyševského 50
 85101 Bratislava
 Tel: +421-2-59 19-3053
 Fax: +421-2-59 19-3048
 www.tatraleasing.sk

Sloveni

Raiffeisen Leasing d.o.o.
 Letališka cesta 29a
 SI-1000 Ljubljana
 Tel: +386-1-241-6250
 Fax: +386-1-241-6268
 www.rl-sl.si

Ukrainë

LLC Raiffeisen Leasing Aval
 Moskovskiy Prospect 9
 Build. 5 Office 101
 04073 Kiev
 Tel: +380-44-590 24 90
 Fax: +380-44-200 04 08
 www.rla.com.ua

Zyrat e përfaqësimit dhe degët - Evropë

Francë

Zyra Përfaqësuese e RBI në Paris
 9-11 Avenue Franklin D. Roosevelt
 75008 Paris
 Tel: +33-1-45 612 700
 Fax: +33-1-45 611 606

Gjermani

Dega RBI në Frankfurt
 Eiesenhüttenplatz 26
 60 329 Frankfurt
 Tel: +49-69-29 921 924
 Fax: +49-69-29 921 9-22

Suedi

Zyra përfaqësuese e RBI
 Vendet Nordike
 Drottninggatan 89, 14th floor
 11360 Stockholm
 Tel: +46-8-440 5086
 Fax: +46-8-440 5089

Mbretëria e Bashkuar

Dega e RBI në Londër
 Leaf C 9th Floor, Toëer 42
 25 Old Broad Street
 London EC2N 1HQ
 Tel: +44-20-79 33-8000
 Fax: +44-20-79 33-8099

Degët dhe zyrat përfaqësuese - Azi dhe Amerikë

Kina

Dega e RBI në Pekin
 Beijing International Club Suite 200
 2nd floor
 Jianguomenëai Dajie 21
 100020 Beijing
 Tel: +86-10-65 32-3388
 Fax: +86-10-65 32-5926

Zyra Përfaqësuese e RBI në Zhuhai

Room 2404, Yue Cai Building
 No. 188, Jingshan Road, Jida,
 Zhuhai, Guangdong Province
 519015, P.R. China
 Tel: +86-756-32 3-3500
 Fax: +86-756-32 3-3321

Indi

Zyra Përfaqësuese e RBI në Mumbai
 501, Kamla Hub, Gulmohar Road,
 Juhu
 Mumbai – 400049
 Tel: +91-22-26 230 657
 Fax: +91-22-26 244 529

Kore

Zyra Përfaqësuese e RBI në Kore
#1809 Le Meilleur Jongno Toën
24 Jongno 1ga
Seoul 110-888
Republic of Korea
Tel: +82-2-72 5-7951
Fax: +82-2-72 5-7988

Singapor

Dega e RBI në Singapor
One Raffles Quay
#38-01 North Toëer
Singapore 048583
Tel: +65-63 05-6000
Fax: +65-63 05-6001

SHBA

RB International Finance (USA) LLC
1133 Avenue of the Americas,
16th Floor
10036 Neë York
Tel: +1-212-84 541 00
Fax: +1-212-94 420 93

Vietnam

Zyra Përfaqësuese RBI
Ho-Chi-Minh-City
35 Nguyen Hue Str.,
Harbour Vieë Toëer
Room 601A, 6th Floor, Dist 1
Ho-Chi-Minh-City
Tel: +84-8-38 214 718,
+84-8-38 214 719
Fax: +84-8-38 215 256

Krijimtari

